



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN



Pranuar me: Primlajeno:	16.02.2024	
Mjesia Jednica:	Numri Srejt	Shtojca Dodatak
15-052/01-10351		

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

DATE	16.02.2024
NGA	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit
PËR	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal Lipjan
LËNDA	Raporti Janar – Dhjetor 2023 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve komunale



I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal z. Daut Azemi

Me anë të kësaj shkrese po ua dërgoj raportin Janar – Dhjetor 2023 të punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Ky raport për periudhën e lartëcekur, paraqet punën dhe aktivitete e realizuara dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale për raportimin e Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---



**R A P O R T**  
**I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE**  
**DREJTORATEVE KOMUNALE**  
**JANAR – DHJETOR**  
**2023**

Shkurt, 2024

## PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	5

## ZYRA E KRYETARIT

1. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore .....	5
2. Avokatja Publike Komunale .....	6
3. Sektori për Marrëdhënie me Publikun .....	7
4. Njësia për Auditim të brendshëm .....	8
5. Sektori i Personelit .....	10
6. Sektori pronësor – juridik .....	13
7. Zyra Lokale për Komunitete .....	13

## DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	15
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale .....	20
3. Drejtorati për Arsim .....	36
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport .....	48
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa .....	50
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim .....	60
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	62
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	68
9. Drejtorati për Infrastrukturë .....	69
10. Drejtorati për Inspeksion.....	73
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.....	76
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	79
13. Drejtorati i Prokurimit.....	82

## FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,  
I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,  
Të nderuar këshilltarë, media e ju të pranishëm,

Më lejoni që para jush të prezantoj raportin vjetor të punës së Ekzekutivit të Komunes tonë.

Mund të them me përgjegjësi të plotë se ne kemi arritur që ta përmbyllim këtë vit me sukses, ashtu edhe qysh e kishim planifikuar në planin tonë të punës.

Në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore.

Jam mëse i kënaqur me rezultatet e arritur nga Komuna e Lipjanit. Një ndër objektivat kryesore ka qenë transparenca dhe publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raporteve rreth inkasimit të të hyrave vetanake dhe menaxhimin e pasurisë. Në raportin e fundit të publikuar nga Instituti GAP "Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave", Komuna e Lipjanit renditet e para për transparencë Buxhetore. Lipjani bën pjesë në kuartilin e lartë dhe me 100 pikë të grumbulluara është renditur si komuna më transparente. Gjithashtu KDI në raportin saj, rendit Lipjanin komunën e dytë më transparente në Kosovë.

Ndërsa në raportin e MAPL-së në projektin DEMOS, Komuna e Lipjanit ka përfituar Grant Përfomance në vlerë 1,843.786.22 €.

Më duhet të theksoj se edhe këtë vit e hyra vetanake në komunën tonë shënon progres të jashtëzakonshëm duke tejkaluar planifikimin buxhetor, ku deri në fund të këtij viti (2023) në total e hyra vetanake ka kaluar planifikimin fillestar për 50.69%.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2023 janë ekzekutuar projekte në infrastrukturë dhe disa të tjera kanë filluar siç është "Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qëndror të qytetit dhe parkingu nëntokësor, fillimi i ndërtimit të QKMF-së, ndërtimi i rrugës "Bashkim Krasniqi" në Lipjan, dhe projekte të tjera.

Në fushën e arsimit, vitin 2023 kemi përruruar çerdhën në Shalë dhe në Ruc të Ri. Shkolla fillore në Ribar të Madh, renovime efikente të disa shkollave në paralele të ndara me çka janë krijuar ambiente më të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kemi ndarë bursa për rreth 180 studentë në vlerë totale prej 86.000.00 euro.

Gjatë vitit 2023, është realizuar renovimi i plotë i QMF-ve Gadime dhe Janjevë si dhe i AMF-së në Babush. Përveç që kemi vazhduar me ndërtimin e kapaciteteve të plota në QKMF Lipjan ne po ashtu kemi pasuruar flotën e kësaj qendre me blerjen e dy autokombive për pacientë me hemodializë.

Kemi vazhduar subvencionimin me sera dhe mekanizëm bujqësorë për ekonomitë familjare, në bashkëpunim edhe me donatorë e partnerë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë. Janë subvencionuar rreth 900 fermerë lipjanas ku shuma totale kalon gjysmë milioni euro (543.893.00 euro)

Lipjani është bërë komuna e parë në nivel vendi që ka bërë lansimin e projektit dixhital "Harta Dixhitale Komunale". Kjo platformë do të shërbejë shumë jo vetëm për çështjet e identifikimit të pronave por edhe identifikimit në prona për të zhvilluar biznes, për ata që duan të vizitojnë vendet më atraktive të qytetit tonë.

Në vitin 2023 gjegjësisht me 28 Nëntor kemi përruruar Palestën Sportive e cila i plotëson të gjitha kushtet për klubet tona sportive dhe që ofron standardet bashkohore në realizimin e ndeshjeve kombëtare e ndërkombëtare. Si gjithmonë edhe vitin që lamë pas kemi subvencionuar Klubet Sportive dhe aktivitete të tjera rinore e kulturore me rreth 200 mijë euro.

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2023, nga 210 aktivitete dhe projekte të planifikuara që dalin nga Plani i Veprimit si pjesë e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019 - 2023, kemi arritur që në vitin që lam pas të realizojmë 201 prej tyre.

Në mirëpritje të mërgatës tonë është mbajtur aktiviteti tanimë tradicional "Mërgata Fest&Sport", organizimi i tre netëve me muzikë, DJ dhe gara të ndryshme sportive që po i jep gjallëri gjithënjë e më shumë qytetit të Lipjanit. Poashtu kemi vazhduar me edicionin e 4 –të të festivalit tradicional për fëmijë "Lipjani Këndon", një mundësi e mirë që gjeneratat e reja të shpalosin talentet e tyre në fushën e kulturës dhe këndimit. Jane zhvilluar edhe nje varg të aktivitete tjera kulturore dhe sportive gjatë tërë vitit 2023.

Gjithashtu, për herë të parë është mbajur edhe “Rinia Fest” i cili synojmë të jetë edhe në vitet e ardhshme.

Edhe këtë vit, kujdesi ndaj hapësirave publike ka vazhduar në mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e lumenjve, mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes si dhe mirëmbajtjen e shtatoreve, lapidarëve dhe varrezave. Komuna jonë poashtu ka pranuar dy auto-fshesa nga GLZ-i në garën për ambient të pastër.

Kemi realizuar asfaltimin e shtigjeve të ecjes në Sllovi, asfaltimin e rrugës “Vehbi Kozhani”, rrugëve dhe rrugicave në Gadime të Epërme, Gadime të Ulët, Sllovi, Qylagë, Magurë dhe në shumë fshatra të tjera. Një pjesë e këtyre punimeve do të vazhdojë edhe në vitin 2024.

Është bërë izolimi i efijencës në objektin shumë banesor në qendër të qytetit.

Është bërë nënshkrimi i kontratave për grante për gratë me organizata të ndryshme joqeveritare, siç janë Help, Integra, Qatar, Islamic Relief, Preda Plus etj.

Vitin që lam pas është e rëndësishme së veçantë të theksojmë ndarjen e 10 banesave për 10 familje me gjendje të vështirë ekonomike e sociale.

Gjatë vitit që lam pas janë nënshkruar 42 marrveshje bashkëpunimi me partnerë vendorë e ndërkombëtarë. Bashkëpunimi me institucione vendore e ndërkombëtare gjithësesi ka shënuar progres në avancimin e shërbimeve dhe investimeve në teren. Sot komuna jonë është partnere në shumë projekte të cilat gjatë vitit 2024 do të implementohen.

I nderuar kryesues,  
Të nderuar këshilltar komunal dhe  
Ju të dashur qytetarë,

Konsideroj se në aktivitetet tona objektiv e përhershme mbetet qeversija e ligjshme, transparente dhe llogaridhënëse. Mirëpo çdo herë periodhat raportuese reflektohen edhe me sfida të ndryshme që kemi para vetës.

Besimi i juaj dhe bashkëpunimi me qytetarë për të menagjuar interesin publik, është motivimi kryesor për të shtuar përkushtim në realizimin e sa më shumë projekteve që komuna e jonë të avancojë çdo ditë e më shumë.

Te dashur qytetarë,

Qyteti ynë, pavarisht sfidave po rritet, Komuna jonë mbetet komuna me progres të jashtëzakonshëm, Lipjani mbetet konkurent i fortë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Do të vazhdoj të angazhohem fort e me përgjegjësi të zhvillojmë vendin tonë, komunën tonë. Mbështetja juaj është determinuese e sukseseve tona.

**Imri Ahmeti**

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për periudhën janar – dhjetor 2023, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar- Dhjetor 2023, angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disciplines në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

## ZYRA E KRYETARIT

### SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

#### PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka vazhduar me përcjelljen e zakonshme të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës si dhe harmonizimin e akteve të Komunës me dispozitat e reja ligjore.

Kemi dhënë këshilla juridike dhe kemi ndihmuar Drejtoratet dhe sektorët e tjerë të komunës edhe në përplimin e akteve apo rregullimin e pjesës hyrëse- bazës ligjore sipas kërkesave të tyre si dhe kemi dhënë opinione të ndryshme rreth nënshkrimit të Memorandumeve apo Marrëveshjeve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Gjatë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform legjislacionit në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nëpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët ti dërgojë në Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit te përpunuesit sipas kompetencës.

#### PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-dhjetor 2023, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Propozim Rregullorë dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

#### STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-dhjetor 2023:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	<b>601 vendime gjithsej</b> 464 vendime me karakter individual jo të përgjithshëm ndërsa 137 vendime me karakter të përgjithshëm
2.	Shkresat	303
3	Urdhëresa	4
4.	Kontrata	18
5.	Marrëveshje	379
6.	Propozim Rregullorë dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës	46

Nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për periodën janar-dhjetor 2023, pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2023 në pajtim me dispozitat ligjore sipas vendimeve të kryetarit të komunës janë shpenzuar të gjitha mjetet e planifikuara në këtë kategori.

## ZYRA E AVOKATURËS PUBLIKE KOMUNALE

### Përmbledhje e përgjithshme e raportimit

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve Zyra e Avokaturës Publike Komunale, brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon;

Nga viti 2022 janë bartur për këtë vit gjithsej 1631 (civile, përmbartimore, penale dhe administrative) lëndë që janë ende në punë.

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve brenda afatit 1 Janar – 31 Dhjetor 2023, bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndët	Numri i lëndëve
Lëndë të pranuar civile	422
Lëndë të pranuar përmbartimore	152
Lëndë në procedurë administrative brenda institucionit	19
Seanca të mbajtura	646
Ankesa të ushtruara në Gjykatën e Apelit (civile dhe përmbartimore)	192
Përgjigje në Padi të ushtruara	420
Prapësime në procedurë përmbartimi	26
Propozime për përmbartim	2
Padi të ushtruara	5
Lëndë të arkivuara civile	152
Lëndë të arkivuara përmbartimore	33

### Përshkrimi i natyrës së lëndëve të pranuar

Nga 422 lëndë (padi dhe propozime) të pranuar;

387 kanë të bëjnë me lëndët e arsimit, pra kërkesa që dalin nga kontrata kolektive siç janë: paga jubilarë, paga përcjellëse, ushqim, udhëtim, inflacion, kualifikim dhe orë me klasë të kombinuara.

19 janë propozime për ndryshimin e çmimit (vlerës) për shkak të shpronësimit për projektet e Komunës siç janë Parku i Qytetit dhe parkingu nëntokësor si dhe rregullimi i trasesë në rr. “Halil Meta” – “Bajram Gashi”.

1 që ka kundërshtuar në tërësi shpronësimin për projektin e Komunës “Parku i Qytetit dhe parkingu nëntokësor”.

9 janë padi për kompensimin me pagë e 13-të nga lëmi i shëndetësisë ku në një nga seancat e mbajtura kemi propozuar që të dëgjohet ZKF i Komunës në lidhje me (pa) mundësinë e pagesave të pagave të 13-ta.

4 janë padi për kompensimin e dëmit, me rastin e shtrimit të rrugëve dhe asfaltimit të tyre pretendohet që Komuna ka prekur pronat private pa pëlqimin e pronareve dhe tani kërkohet kompensimi për dëmin e shkaktuar.

2 padi kanë të bëjnë me vërtetimi e pronësisë në patundshmëri, njëra në fshatin Ribar i Madh dhe tjetra në fshatin Sllovi.

Në dobi të Komunës veçojmë lëndët e vlerës së konsiderushme, si më poshtë

- C.nr. 33/14, kompensim dëmi prej 60'126.78 € (do të kërkohej me përmbartim nga Komuna pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit).

- C.nr. 297/17, kompensim dëmi material dhe jo-material, vlera 150'000.00 €.

- C.nr. 565/17, kompensim dëmi, vlera 29'621.24 €.
- C.nr. 130/17, vërtetim pronësie (Ribar i Madh).
- C.nr. 356/17, vërtetim pronësie (Smallushë).
- A.nr. 1258/20, shlyrje e tatimit në pronë, vlera 80'000.00 €.
- C.nr. 854/20, kompensim dëmi, vlera 34'286.13 €.
- C.nr. 457/13, vlera e kontestit 60'000.00€, kompensim për dëmet e shkaktuar pas luftës - e tërhequr.

## Sfidat

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfida kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Gjithashtu sfidë tjetër është e Kontratave kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë e përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontratë në procedurë administrative në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësore dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

## SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

### PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sektori për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2023 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit të vazhdojë të jetë në mesin e komunave të para sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Në web faqen zyrtare të Komunës ka vazhduar publikimi i materialeve të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shtesë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë material të tjera.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti me një transparence të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar drejtëpërdrejtë në kanal zyrtarë të komunës në Youtube.

### PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka kryer punët në vijim:

Është bërë përcjellja e aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, po ashtu janë përcjellur edhe aktivitete të tjera që ka zhvilluar ekzekutivi si dhe Kuvendi e Komitetet. Aktivitetet janë përcjellë brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj është bërë përgatitja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

- Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;
- Janë publikuar në web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, Publikimi i raporteve të drejtorëve për gjatë tërë vitit. Po ashtu janë publikuar në web faqe vendime, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë dërguar në zyrën për informim;
- Është bërë publikimi i kontratave të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoria e Prokurimit. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike.
- Rëndësi të veçantë është kushtuar përditësimit të web faqes së komunës duke ofruar informacione të rëndësishme për qytetar, si publikimi i konkurseve, thirrjet për grande, thirrjet për subvencionim e shumë dokumente të tjera.
- Materiale të ndryshme që i'u janë drejtuar zyrës për komunikim me publikun janë publikuar edhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, platformën e konsultimeve publike të qeverisë së Kosovës dhe në gazetatat ditore për të cilat kërkohet me ligj.
- Gjatë periudhës raportuese është bërë azhurimi dhe mirëmbajtja e panelëve në tri hyrjet kryesore të qytetit të Lipjanit.
- Po ashtu në periudhën e vitit 2023 është menaxhuar kontrata lidhur me shërbimet mediale në komunën e Lipjanit.
- Hartimi i planit për transparence në Komunën e Lipjanit 2023 – 2027.



- Sektori për marrëdhënie me publikun në vitin 2023 ka përgatitur dhe publikuar Listën e Hollësishme të Shërbimeve që ofron Komuna e Lipjanit.
- Kemi filluar me publikimin e draft Agjendës javore të takimeve të Kryetarit në web faqen e Komunës së Lipjanit.

## STATISTIKAT

Nr.	Emërtimi	Publikimet
1	Reportazhi vjetor	1
2	Lajme në web	Mbi 350
3	Marrëveshje	42
4	Vendimet e kryetarit	137
5	Raportet e kryetarit	2
6	Qasje në dokumente publike	39
7	Raporti i auditorit	1
8	Raporte për diskutime publike	14
9	Procesverbalet e konsultimeve	19
10	Deklarimi i pasurisë	2023
11	Raporte të drejtorateve	Mbi 140
12	Kontrata të prokurimit	119
13	Dokumente të ndryshme nga Drejtorati i Prokurimit	500
14	Vendime të OSHP-se	14
15	Konkurse	78
16	Njoftime	246
17	Raporte dhe dokumente nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa	30
18	Thirrjet dhe Ekstraktet e KKS-së	12
19	Buletin	12
20	Vendime dhe akte të tjera nga kuvendi	58
21	Materialet e kuvendit	11 + 1 seancë përkujtimore
22	Procesverbale dhe ftesa nga sektori i kuvendit	76

## TAKIME E NDRYSHME

Janë zhvilluar takime të ndryshme me gazetarë nga mediat e ndryshme të shkruara dhe elektronike, takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyrës sonë për informata rreth komunës po ashtu ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve përmes thirrjeve telefonike në numrin e zyrës së informimit.

## SFIDAT

Ndër sfidat që na ka përcjellur kryesisht janë problemet me funksionimin e web faqes zyrtare të komunës, ku edhe për gjatë periudhe kemi pasur shumë pengesa rreth publikimit të dokumenteve Po ashtu është bërë edhe ripublikimi i shumë dokumenteve të tjera pasi që shumë të dhëna janë fshirë nga web faqja gjatë këtyre muajve.

## NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

### PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me aprovimin e Ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar nr. me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës, kështu në Muajin Dhjetor të vitit paraprak është përpiluar Plani Strategjik Trevjeçar 2021-2023 në të cilin janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të Auditimit për të gjitha fushat e Auditimit.

-Pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar, pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë është bërë rangimi i detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

-Plani strategjik për vitet 2023-2025 , dhe plani vjetor i punës për vitin 2023, pas përpilimit nga udhëheqësi i NJAB-së janë prezantuar për shqyrtim në Komitetin , dhe janë aprovuar nga Udhëheqësi i SSP brenda afatit ligjor 31. Dhjetor dhe pas miratimit të tyre janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe janë dërguar edhe në NJQHAB.

Angazhimi i NJAB në vitin 2023, ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2023 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera , pas pranimit të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final , ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001 , me të cilën ka njoftuar edhe ZKA –an lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB .

-Puna që është kryer gjatë periudhës Janar 2023-Dhjetor 2023, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2023 , kishte planifikuar Auditime të rregullta, 10 detyra ( auditime) për dhënie të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore Komuna e Lipjanit .

Nga dhjetë Auditimet e planifikuara NJAB ka realizuar 100% planin e punës duke ofruar 10 raporte finale për entitetet e audituara.

Nga dhjetë auditime të kryera nga NJAB nëntë auditime kanë qenë auditime të pajtueshmërisë dhe financiare dhe një Auditim për herë të parë ka qenë Auditim i performancës.

## **PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Gjatë vitit 2023 NJAB ,ka Finalizuar 10 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

-Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2022, Fushëveprimi : 01.01.2022 - 31.12.2022.

-Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë Periudha Janar 2022 -Janar 2023

-Auditimi i të hyrave të arkëtuara në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për periudhën 01.07.2021 – 15.03.2023.

-Auditimi i Shpenzimeve në Drejtorinë Komunale të Arsimit për periudhën 01.04.2021-31.03.2023”.

-Auditimi i procesit të Hyrave në drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm” Fushëveprimi i auditimit është periudha prej 01.04.2022 - 31.05.2023.

-Auditimi i zyrës për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën 01.07.2021-30.06.2023.

-Auditimi i procedurave për menaxhimin e kontratave me rastin e implementimit të projekteve D.I ., fushëveprimi periudha Qershor 2022 -Muajin Qershor 2023

-Auditimi i performances ,, dy projektet e realizuara me bashkëfinancim me DEMOS

-Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale ( 13 programet buxhetore ) fushëveprimi : prej 01.10.2022. -30.09.2023.

-Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale“ për periudhën 01.11.2022. -30.10.2023.

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2023 , NJAB ka monitoruar edhe shkallën e zbatimit të rekomandimeve ( progresin e zbatimit), duke kryer nëntë rishikime të planeve të zbatimit për rekomandimet e lëshuara nga NJAB dhe të cilat afatin e zbatimit e kanë pasur në vitin 2023.

NJAB po ashtu gjatë vitit 2023 ka kryer edhe dy rishikime të planeve të zbatimit të rekomandimeve për rekomandimet e pranuar nga Zyra kombëtare e Auditimit , rishikimet janë kryer në Muajin Mars 2023 dhe Muajin Shtator 2023.

Plani i zbatimit të rekomandimeve dhe rishikimi i kryer në Muajin shtator 2023 nga NJAB , janë prezantuar në Asamblenë Komunale .

NJAB në fund të vitit 2023 ju ka dërguar planet e zbatimit të gjitha entitete të audituara për të marrë informata lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB , gjatë vitit 2023 , me qëllim të prezantimit sa më të saktë të shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga NJAB-ëm dhe të cilat prezantohen në Raportin vjetor i cili dërgohet në NJQHAB .

## STATISTIKAT

Për vitin 2023 , NJAB ka kryer 10 Auditime të rregullta të planifikuara të cilat ishin paraparë me planin vjetor të punës për vitin 2022, dhe 9 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit ( kryetarit të komunës ) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve, 2 rishikime për Raportet e ZKA –it gjegjësisht planet e zbatimit .

- Është mbajtur një trajnim me NJQHAB –it me temën Auditimet e performances , si dhe takimi lidhur me prezantimin e përmbushjes së kriterëve për performancë nga lëmia e financave , prokurimit , burimeve njerëzore dhe auditimit të brendshëm me DEMOSIN.

## TAKIME E NDRYSHME

-Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

**Takimi i parë** është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2023 ,për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2022,

-**Takimi i dytë** për raporti për Tremujorin e parë 2023 , ( TM1-2023) , takimi është mbajtur në Muajin Prill- 2023.

**Takimi i tretë** me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë( TM2-2023) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Korrik 2023 .

**Takimi i katërt** me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë( TM3-2023) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2023 .

**Takimi i pestë** me Komitetin e Auditimit për aprovimin e planit strategjik të NJAB-së për vitet 2025-2026 dhe planit vjetor punës për vitin 2024, është mbajtur në fund të Muajit Dhjetor 2023 , ku është miratuar plani i punës për NJAB-në nga Komiteti i Auditimit dhe është aprovuar nga Kryetari i Komunës.

## SEKTORI I PERSONELIT

### PËRMBLEDHJA E PËRGHITHSHME E RAPORTIMIT

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore kujdeset për të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë, në pajtim me dispozitat e ligjore në fuqi. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të saj. Në Administratën Komunal sipas Strukturës Organizative të Administratës Komunale kemi 231 pozita të planifikuara ku aktual kemi 204 zyrtar, prej tyre shërbyes civil meshkuj kemi 112, ndërsa femra 67, me aftësi te kufizuar i kem 3 prej tyre dy meshkuj, dhe një femër.

### PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Njësi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike. Siguron zbatimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, pushimet, trajnimet, administron sistemin për vijueshmërinë në punë, procedurat disiplinore, procedurat e ankesave, mbështet dhe organizon punën e Komisionit Disiplinor për nëpunësit e shërbimit publikë dhe Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publikë, pezullimin e marrëdhënies së punës, transferimin e nëpunësve, përfundimin e marrëdhënies së punës – lirimim nga shërbimi civil, vërtetimet, statistikat e të punësuarve etj., në bazë të legjislacionit në fuqi.

## STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raportet- Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2023	12
2	Aktemrime	17
3	Kontratë pune	2
4	Kontratë pune për praktikant me pagesë	31
5	Autorizim / vendim për autorizim	8
6	Punimi i Planit të Personelit për Administratën Komunale, Arsim, Shëndetësi, dhe shtëpinë e komuniteteve	4
7	Raport për Ekspert të Jashtëm	1
8	Pani i trajnimeve	1
9	Punimi i përshkrimit të detyrave të punës	92
10	Përditësimi i të dhënave Personale të zyrtarëve të Administratës Komunale në SIMBNJ	/
11	Numri i të punësuarave ne Administratën Komunale, Zjarrfikësit, Qendra Sociale dhe Rezidenciale dhjetor 2023 (179+17+8)	181
<b>SHKRESAT PER ANTIKORRUPSION</b>		
12	Tabela informuese për Antikorrupsion	1
13	Listat për deklarim të rregullt në Antikorrupsion	66
14	Lista për Antikorrupsion	8
15	Regjistrimi i zyrtarëve të lartë publik në DMSA antikorrupsion	66
16	Shkresë zyrtare për deklarim të pasurisë	1
17	Shkresa lidhur me njoftimin e zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë së rregullt muajin mars	1
18	Punim i formularit për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë 1 deri 31 mars 2023 në formular Excel	1
19	Shkresë njoftim për mbarim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
20	Shkresë njoftim për emërim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
<b>LISTAT</b>		
21	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	275
22	Raporti i listave ardhje dhe shkuarje për punëtorët	149
23	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	260
24	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për praktikantë	60
<b>PUSHIMET</b>		
25	Pushime mjekësore.	77
26	Pushime vjetore.	239
<b>FORMULARET PER NDRYSHIME</b>		
27	Punimi i formularëve për ndryshime	134
28	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar	12
29	Punimi i formularëve për punëtore të rinj	22
30	Punimi i formularëve për transferim bankar	4
31	Punimi i formularëve për retroaktiv	73
32	Punimi i formularit me te dhënat për zyrtaret publik për MBPB	/
33	Punimi i formularëve për pagë sekondare	4
<b>VERTETIMET</b>		
34	Vërtetim për kryerjen e praktikës	37
35	Vërtetim për përvojë të punës	35
<b>VENDIMET</b>		
36	Vendim për pushim ditore për nënat lehonë për mbrojtjen e të Ushqyerit të fëmijës	4
37	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies se punës	11
38	Vendime për kryerjen e praktikës	24
39	Vendim për Ndalesë	3
40	Vendim për pagesa jubilarë	1
41	Vendim për emërim	1
42	Vendim për emërimin e drejtorëve	14
43	Vendim për Pushim të Lehonisë	2
44	Vendim për ndryshim dhe plotësim të strukturës organizative të administratës komunale	1
45	Vendim për Transferime	3
46	Vendim për përvojë të punës	8
47	Vendim për emërimin të drejtorëve	14
48	Vendime për punë pa orar të përcaktuar	1
49	Vendim për ndryshim të koeficientit	3
50	Vendim për formimin e komisionit për klasifikimin e vendeve të punës të Administratës Komunale	3

51	Vendime për Udhëtime Zyrtare	29
52	Vendim për shfuqizim të vendimit	4
53	Vendim për pushim pa pagesë	3
54	Vendim për pagesë shtesë	1
55	Vendim për shfuqizim të kontratës	2
56	Vendim për Komision Disiplinorë	1
57	Vendim për ushtrues detyre	2
58	Vendim për klasifikimin e vendeve të punës	3
<b>KONKURSET</b>		
59	Kërkesa për aprovim të konkurseve( Konkurs i brendshëm, Pranim, Nëpunës teknik)	45
60	Publikimi i konkurseve në Administratën Komunale ( Konkurs i brendshëm, Pranim, Nëpunës teknik)	45
61	Publikimi i konkurseve për Arsim dhe Shëndetësi	31
62	Vendim për Formimin e Komisionit Rekrutues	22
63	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve SIMBNJ	193
64	Njoftim për procedurat e rekrutimit	65
65	Vendim për refuzimi të Aplikacioneve	52
66	Përgjigje në ankesat e procedurave te rekrutimit	7
67	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	1
68	Mbajtja e Intervistës	16
69	Mbajtja e testit me shkrim	9
70	Njoftim për mbajtje të test me shkrim	9
71	Njoftim për mbajtje të intervistës me gojë	16
72	Njoftim për anulim të konkurseve	3
<b>KERKESAT</b>		
73	Kërkesë për Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/ DMZP ( pagesa retroaktive, pagë jubilarë, korrigjim të koeficientit në listë të pagave)	13
74	Kërkesa për pagesë për ekspertin e jashtme	2
75	Kërkesa të ndryshme	17
76	Kërkesë për Komision Disiplinor	2
77	Kërkesa për MEF	2
78	Kërkesë për pagë jubilarë	2
79	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	20
<b>PERGJIGJET</b>		
80	Përgjigje në Kërkesë për Avokatin	18
81	Përgjigje në Kërkesë për një pagë me rastin e pensionimit	2
82	Përgjigje në kërkesë për masë disiplinore	8
83	Përgjigjeje në Kërkesat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	105
84	Përgjigje në Ankesë	1
85	Përgjigje në kërkesë për pagesën e komitetit	1
86	Përgjigje në kërkesa të ndryshme	11
87	Përgjigje në kërkesë për koeficient	58
88	Përgjigje në kërkesë për orë shtesë dhe anëtarët e ngushtë të familjes	3
89	Përgjigje në shkresa të ndryshme zyrtare për mes email-ve zyrtare	50
<b>NJOFTIM</b>		
90	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	3
91	Njoftim me rastin e kërkesës për pushim vjetorë për drejtorët dhe udhëheqësit e sektorëve	13
92	Njoftim për vijueshmëri dhe për trajnime	13
93	Njoftim/ ftesë për komision disiplinor	2
94	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	12
95	Njoftim për vlerësimin e rezultateve të punës	13
<b>PËLQJME</b>		
96	Pëlqim për Transferime	3
97	Pëlqim për nënshkrimin e Aktemrimit	14
98	Punimi i planit të punës dhe vlerësimi zyrtarëve komunal në SIMBNJ	3
<b>REGJISTRAT</b>		
99	Regjistri për klasifikimin e vendeve të punës për Administratën Komunale	1
100	Regjistrimi i kërkesave për praktikantë me pagesë	31
101	Kompletimi i dosjeve me të dhëna personale sipas ligjit të ri	157
102	Regjistri për Demosin	1
103	Regjistri i trajnimeve	192
<b>AUDITORET</b>		
104	Kompletimi i lëndëve për Auditorët e jashtëm	1

105	Auditim nga Auditoret e jashtëm	1
106	Kompletimi i lëndëve për Auditor të Brendshëm	1
107	Regjistri për auditorët e jashtëm	1
108	Plotësim i pyetësorit për Auditorë	1
109	Gjithsejtë	3306

## TAKIME TË NDRYSHME

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

## SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

### PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë tërë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

### PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese të vitit 2023 janë përgatitur: Vendime, Shkresa të ndryshme, Pëlqime, Kontrata, Marrëveshje dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

### STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2023:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	36
2.	Shkresa	165
3.	Pëlqime	1
4.	Kontrata	20
5.	Propozim-Vendime	10
6.	Marrëveshje	1

Sektori Pronësoro-Juridik, në procedurë administrative ka pranuar gjithsej 240 lëndë, prej tyre të kryera 233 dhe në procedurë 7 lëndë të natyrave të ndryshme të parashtruara nga Drejtoratet komunale si dhe lëndë të parashtruara nga palët.

### TAKIME E NDRYSHME

Sektori Pronësoro-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës

## ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë kësaj periudhe, ZKKK zyra ka qenë e angazhuar rreth zgjidhjes së problemeve të personave të riatdhesuar, familjet e kthyer dhe komunitetet, puna me organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare dhe puna me institucionet e Kosovës.

### MË POSHTË JANË TË LISTUARA NË MËNYR KRONOLOGJIKE AKTIVITETET E RËNDËSISHME DHE PUNËT E ZKKK

Janë regjistruar 4 familje të riatdhesuara nga Gjermania.

Zyrtarët e ZKKK-së vizituan familjet e riatdhesuara dhe filluan një procedurë për të ofruar ndihmë në riintegrim. Komisioni Komunal për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar ka miratuar 1 kërkesë për strehim të një familjeje të riatdhesuar. Është nënshkruar kontrata me MPB-në për strehimin e 1 familjeje të riatdhesuar dhe 1 azilkërkues. Është dhënë një pako ushqimore dhe higjienike për 1 familjeje të riatdhesuar.

Nëpërmjet Ambasadës Gjermane janë verifikuar dokumentet për 3 persona të riatdhesuar.

Në bashkëpunim me nënkryetarin për komunitete kemi punuar për zgjidhjen e problemit të një familjejeje të riatdhesuar që është në gjendje të keqe ekonomike. Atyre iu dha një pako ushqimore nga përfaqësuesi i xhamisë në Lipjan, familjes iu dha shfrytëzimi i kuzhinës publike dhe në ndërkohë MPB-ja ua dorëzoi një pako ushqimore. Në bashkëpunim me kompaninë D&D arritëm të regjistrojme 2 anëtarë të kësaj familjejeje për të ndjekur punë praktike për 6 muaj. Përmes kompanisë D&D, 11 persona të riatdhesuar ndjekin punë praktike për 6 muaj dhe paguhen 300 € në muaj.

Në bashkëpunim me komandantin e stacionit policor në Janjevë, Departamentin e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, Qendrën për Punë Sociale, kemi punuar në zgjidhjen e çështjes së akomodimit të një personi të kthyer nga Gjermania. Përfaqësuesi i Diakonie-s na kërkoi dokumentet që kemi për këtë person në mënyrë që përmes ambasadës gjermane të mundohet ta ndihmojë këtë person sepse ai është ende në rrugë.

Në bazën e të dhënave të MKK-së janë regjistruar 11 kërkesa për kthim, prej të cilave Komisioni Komunal për Kthim i ka rekomanduar Komisionit Qendror për miratim 5 kërkesa, 4 të refuzohen dhe 2 në pritje për mungesë të pasurisë. MKK aprovoi 2 kërkesa për ndërtimin e shtëpive për familjet e kthyer.

ZKKK ka përfunduar 2 lëndë dhe ka paraqitur kërkesë në Drejtorinë për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Mjedisit për dhënien e lejeve të ndërtimit për ndërtimin e shtëpisë për 2 familje të kthyer financuar nga MKK. Lejet e ndërtimit janë lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe ZKKK. i dorëzoi në MKK.

Në bashkëpunim me organizatën Advancing Together është regjistruar një familje e kthyer nga Maqedonia, e cila është shpërngulur nga Shtimja në Maqedoni dhe është kthyer në Lipjanë. Përmes Advancing Together, ne kërkua të kontrollojmë statusin e një familjejeje që dëshiron të kthehet nga Maqedonia në Lipjan.

Nga FSK-ja jemi njoftuar se do të shpallet konkursi për rekrutimin e kadetëve për vitin akademik 2023-2024. Ne siguruam praninë e grave nga familjet e kthyer për një takim me OSBE-në lidhur me mundësitë e punësimit dhe gjenerimin e të ardhurave. Në Departamentit të Bujqësisë kemi dorëzuar një listë me 24 gra aktive nga komunitetet për anëtarësim në lidhje me zbatimin e projektit të mbështetur nga Fondacioni CNVP. Kemi siguruar po ashtu praninë e grave nga komuniteti në lidhje me informimin e grave për pronën. Mbajtëm një takim me Qendrën Rinore nga Obiliq në lidhje me zbatimin e një kursi të dizajnit grafik për personat e riatdhesuar dhe azilkërkuesit e moshës 16-24 vjeç.

Në takim me UNMIK-un na kanë njoftuar për mundësinë e aplikimit për projektin e besimit ndërmjet komuniteteve. OJQ-të kanë të drejtë të aplikojnë. Vlera e projektit është deri në 25,000 €. Ne mbajtëm një takim me Këshillin Danez për Refugjatët në lidhje me një projekt të financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SIDA). Këshilli Danez do të përdorë informacionin e marrë nga ZKKK për të hartuar projektet e ardhshme. I kemi njoftuar pjesëtarët e komunitetit rom dhe ashkali që nuk e kanë përfunduar shkollën e mesme se DRC do t'i bartë shpenzimet për të përfundon shkollën e arsimit për personat e moshës 18 -35. Një listë me 5 persona të interesuar për të përfunduar shkollën e mesme nga komuniteti shqiptar iu dorëzua Këshillit Danez për Refugjatët. Nuk kishte persona nga komuniteti rom dhe ashkali të interesuar për të ndjekur këtë kurs.

ZKKK ka përgatitur një pjesë të draft Planit të Veprimit për integrimin e komunitetit rom dhe ashkali për periudhën 2023-2026, i cili ishte në domenin e saj të punës. Së bashku me Organizatën Ndërkombëtare IOM, kemi përzgjedhur projektet më të suksesshme nga viti 2010-2019, për të ofruar mbështetje për ata që patën vështirësi në biznes gjatë pandemisë Covid-19.

Me Voice of Roma kemi nënshkruar marrëveshje për të mbajtur punë praktike në kohëzgjatje prej 3 muajsh për një person nga komuniteti ashkali, ku praktikuesi ka filluar të ndjekë praktikën në ZKKK.

Dhënia e asistencës palëve me dokumentacionin e nevojshëm për aplikim në MKK dhe MLS për ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive, materialeve të ndërtimit, mobiljeve, teknikë të bardha dhe plan biznesit.

Janë pranuar 19 kërkesa për ndihmë financiare të njëhershme, prej të cilave 5 janë ridrejtuar në Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Publike, u zgjidh pozitivisht kërkesa e komunitetit serb, i cili kërkonte prerjen e barit në varrezat në Lipjan, Grackë e Vjeter dhe Rubovc. Zyrtarët e ZKKK-së kanë vizituar shkollën fillore “Braça Aksiq” në Lipjan lidhur me thyerjen e xhamit të dritares nga një person i panjohur dhe për këtë problem e kemi njoftuar Drejtorin e Departamentit të Arsimit dhe kemi paraqitur kërkesë për ndërrimin e xhamit të thyer në dritare.

Kemi marrë pjesë në përgatitjen e draft planit të veprimit për integrimin e komuniteteve rom dhe ashkali për periudhën 2023-2026.

Zyrtarët e ZKKK morën pjesë po ashtu në takimin rajonal të organizuar nga MKK. Temë e takimit ishte procesi i kthimit vullnetar dhe planet për vitin e ardhshëm 2024.

Drutë e zjarrit për ngrohje iu kanë dorëzuar me kohë shkollës fillore “Braça Aksiq” dhe departamenteve periferike në Grackë e Vjeter dhe Rabovc.

Në bashkëpunim me Departamentin e Arsimit dhe Institutin për Kërkime dhe të Drejtat e Njeriut, broshura për promovimin e vetëdijes për braktisjen e shkollës u shpërndanë në komunitetet ku komunitetet vijojnë shkollën.

## **DREJTORATET KOMUNALE**

### **DREJTORATI PËR ADMINISTRATË**

#### **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT**

Në Drejtorin për Administratë janë realizuar detyra dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, statutit të Komunës së Lipjanit, ligjet tjera, Udhëzimet, Urdhëresat, si dhe Rregulloret tjera Komunale.

#### **PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE**

Përgjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me menaxherët kemi bërë evidentimin e kontratave që skadojnë përgjatë këtij viti, e që janë të ndërlidhura me Administratën si dhe i kemi proceduar tutje për Planifikim të Prokurimit për vitin vijues, si dhe janë bërë planifikime shtesë të nevojshme për Drejtoratin e Administratës.

#### **SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME**

Raporti për periudhën një vjeçar përmend aktivitetet dhe progresin e ndodhur në disa sektorë të Administratës. Përmendim disa nga aktivitetet kryesore kryesisht në sektorin e Administratës së Përgjithshme, Gjendjes Civile, Punëve të Kuvendit dhe Komiteteve, si dhe Mirëmbajtjes dhe Operimit të organizatës. Përmbledhja e shkrimit paraqitet si më poshtë:

##### **Menaxhimi i Kontratave dhe Planifikimi i Prokurimit:**

Gjatë kësaj periudhe, Drejtorati për Administratë ka evidentuar dhe menaxhuar kontratat që skadojnë gjatë këtij viti, janë realizuar shumë kontrata:

- kontrata e sigurimit fizik në objektet e komunës,
- kontrata me material të imët për Administratën Komunale dhe QKMF në Lipjan,
- realizime të disa procedurave të teknologjisë së IT-së,
- realizimi i sistemit të ujitjes në oborin e komunës,



- realizimi i tabelës së njoftimeve në komunë,

Po ashtu, kemi bërë edhe planin e prokurimit për vitin e ardhshëm, ku janë bërë planifikimet shtesë për vitin e ardhshëm për Drejtoratin e Administratës.

### **Trajnime dhe takime lidhur me shërbimet komunale dhe procedurave administrative:**

Digjitalizimi i shërbimeve, si dhe funksionimi i sistemeve të shërbimeve, intranetit, e-arkiva, të cilat kemi bërë edhe sugjerime rekomandime në bashkëpunim me ASHI dhe akterët e tjerë për të funksionalizuar në mënyrë më efikase të sistemeve. Staf të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve në QSHQ duke treguar më shumë transparencë në marrjen e shërbimeve. Për një periudhë kohore të gjatë, gjatë muajve në sektorin e administratës së përgjithshme në qendrën për shërbime me qytetarë janë regjistruar kërkesat dhe parashtrësat nga qytetarët për protokollim në intranetin komunal, shërbimet postare të shkresave, përgjigjet që kryhen në këtë sektor, shërbimet e arkivave komunale dhe shërbimet e përgjithshme ndaj qytetarëve.

Gjatë kësaj kohe janë organizuar konkurse nga Komuna e Lipjanit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtorati i Arsimit si dhe Drejtorati për Bujqësi ku kishte aplikime për subvencione si dhe aplikime për bursa për student nga Drejtorati i Arsimit. Gjithashtu, janë mbajtur konsulta me qytetarë lidhur me përdorimin e platformës E-Kosova për kryerjen e disa shërbimeve (<https://ekosova.rks-gov.net/Service/5> dhe <https://ekosova.rks-gov.net/Service/1>).

Është dërguar raporti për vitin 2023 të intranetit për zgjidhjen e lëndëve nga drejtoritë komunale ku aktualisht kemi lëndë në proces.

Në muajin dhjetor, komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare të komunës ka bërë inventarizimin dhe me pas ka filluar me raportin final.

Shërbimet po vazhdojnë me cilësi dhe gatishmëri në punë për secilën Kontratë Kornizë. Përpjekjet tona janë për koordinim të mirë dhe përmbushje të detyrave sipas kontratës në fuqi, duke i futur të dhënat në sistemin e prokurimit për transparencë. Kemi caktuar menaxherin e kontratës për shërbimet postare universale, shërbimin e veçantë me rekomandim dhe për shpërndarjen e certifikatave të gjendjes civile.

Menaxhimi i materialit shpenzues për shërbimet në sektorin e administratës së përgjithshme është planifikuar me kohë dhe në mënyrë efikase, por ka pasur edhe shpenzime me letër për të gjitha shërbimet komunale.

Një prioritet aktual është mbushja e një vendi të lirë të punës për shërbimet me qytetarë, për shkak të pensionimit të një zyrtari. Pritet që procedurat e rekrutimit të nisin së shpejti.

Kemi pranuar një praktikante për një praktikë mujore nga fakulteti privatë.

Po ashtu, vazhdojmë të presim nxënës të shkollës Adem Gllavica në drejtimin juridik, duke i ofruar informacione lidhur me mësimet dhe praktikat në shërbimet komunale në aspektin administrativ dhe juridik.

Gjatë këtij viti në sektorin e administratës së përgjithshme, në qendrën për shërbime me qytetarë, kemi pasur një fluks të konsiderueshëm të kërkesave nga qytetarët për protokollim në intranetin komunal, shërbimet postare të shkresave, si dhe shërbimet e arkivave komunale.

Po ashtu, kemi vazhduar me punën në komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare të komunës, duke kryer inventarizimin e institucioneve komunale në Lipjan.

### **Gjatë muajit kemi mbajtur një aktivitet për USAID KMI punëtori një ditore me temë, “Menaxhimin e Kontratave Publike” për Menaxheret e Kontratave.**

Në muajin shtator ka qenë afati për futjen e të dhënave në sistemin e performancës si dhe kemi marrë dëshmi nga ASHI lidhur me numrin e përdorimit të E-Kosova në shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e pronës, shërbimet e tatimit në pronë si dhe numri i pagesave.

Punëtori për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të performancës komunale të organizuar nga MAPL në bashkëpunim me organizatat e ndryshme, Helvetas Kosovo, etj.

Ne si përfaqësues të komunës në fushën përkatëse kemi dhënë sugjerimet dhe komentet lidhur me fushat dhe treguesit e performancës në fushën përkatëse.

Nga data 02/11/2023 është mbajtur një takim i organizuar nga OSBE për temën e digjitalizimit të shërbimeve komunale dhe funksionimit të ueb faqes komunale. Kryetarët e këshillave të fshatrave, organizatat e grave dhe ASHI kanë marrë pjesë në këtë

takim, i cili ishte i frytshëm me diskutime të ndryshme dhe prezantim të shërbimeve elektronike të ofruara nga komuna dhe E-Kosova.

Gjatë këtij muaji, kemi pritur Dekanin e Fakultetit AAB -së të Administratës Publike, si dhe koordinatorin për cilësi të këtij fakulteti, diskutuam tema të ndryshme lidhur me shërbimet e ofruara nga qendra për shërbime me qytetarë si dhe bashkëpunimin e institucionit nga Drejtoria e Administratës në komunën e Lipjanit. Qëllimi i këtij takimit ishte një bashkëpunimin i dyanshëm i rekomandimeve.

- Formimi i grupit punues nga Drejtoria e Administratës për identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e veprimeve ndaj rrezikut në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve nga drejtoria përkatës në komunën e Lipjanit.

Formimi i grupi punuese nga drejtoratin për administratë për ri-hartimin e planit të ri të integritetit për Komunën e Lipjanit. Komision për hartimin e planit të veprimit për transparencën komunale gjithashtu edhe kemi plotësimin e pyetësorit për Integrim Evropian nga drejtoria e administratës.

## STATISTIKAT:

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
•	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	15190
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	505
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	41629
•	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	0
4	Aktvendime të Shpërndara	479
5	Ftesa të Shpërndara	1537
6	Vendime të Shpërndara	463
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	68
8	Njoftime të Shpërndara	671
9	Të Arritura me Postë	922
10	Të Dërguara me Postë	2168
11	Fatura tatimore të Qirasë	153
12	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 2,1058€	
	<b>Gjithsej</b>	<b>63785</b>

## SEKTORI I GJENDJES CIVILE

Në sektorin e Gjendjes Civile, të gjitha shërbimet janë realizuar në mënyrë transparente, dhe me korrektësi me shërbime të shpejta të cilat janë dhënë për qytetarët.

Respektivisht në udhëzim administrativ (MPB) Nr.01/2022 për dokumentet e gjendjes civile, për përdorim brenda vendit lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4, ndërsa dokumentet e Gjendjes Civile për përdorim jashtë vendit lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil, ashtu siç janë lëshuar deri më tani.

Po ashtu, edhe ndryshimi i procesverbalit i pranimit të atësisë/amësisë nuk është më dokument i Gjendjes Civile, i cili duhet ti lëshohet qytetarit, ky dokument përdoret për procedurat e brendshme të Gjendjes Civile, dokument i cili mbahet në dosjen e qytetarit, si dhe Dëshmia e Vdekjes më nuk lëshohet nën mbikëqyrjen apo autoritetin e Agjencisë së Regjistrimit Civil, respektivisht të Drejtoratit të Gjendjes Civile, ky dokument tani e tutje lëshohet në një formular me logon e Komunës tonë.

Në platformën E – Kosova është lansuar sistemi i shërbimeve, ku çdo qytetarë i regjistruar mund të paiset me dokumente të gjendjes civile të cilat janë në E-Kosova.

Si prioritet i punës kanë qenë shërbimet e kërkuar nga mërgimtarët.

**STATISTIKAT:**

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	19083
2	Certifikatë e martesës	4554
3	Certifikatë vdekje	1939
4	Certifikatë Vendbanimi	1931
5	Vërtetim nga arkiva	389
6	Certifikatë Shtetësie	333
7	Certifikatë e Statusit martesor	1101
8	Certifikatë të lindjes	11148
9	Certifikatë e Bashkësisë familjare	5017
10	Regjistrimit e reja në LAL	118
11	Regjistrimet e mëvonshme në LAL	175
12	Regjistrimet e reja në LAM	364
13	Regjistrimet e më vonshme në LAM	321
14	Regjistrimet e reja në LAV	90
15	Regjistrimet e më vonshme në LAV	78
16	Aktvendime nga lëmin e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	71
	<b>Gjithsej</b>	<b>48562</b>

**SEKTORI I KUVENDIT**

Në sektorin për punë të kuvendit dhe komiteteve janë realizuar të gjitha punët në kuadër të planit dhe përgjegjësi. Përmbledhje e shkurtër e punëve që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve: përgaditja e materialit në mënyrë fizike, janë mbajtur procesverbalet dhe janë hartuar ekstrakte për 12 mbledhje të Kuvendit të Komunës, 11 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, 12 mbledhje të Komitetit për Komunitete, 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe për disa mbledhje të Komitetit për Arsim, Komitetit për Shëndetësi, Komitetit për Kulturë Rini e Sport. Për mbledhjet e sipërshënuara të Kuvendit i është dërguar materiali në mënyrë elektronike Kryetarit, Nënkryetarëve, Drejtorëve, anëtarëve të kuvendit, sektorit të informimit si dhe në Ministrisë përkatëse etj. Po ashtu edhe vendimeve e rregulloreve të aprovuara.

Aktet juridike nënligjore të aprovuara në Kuvend fillimisht janë dërguar në Ministrinë përkatëse për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre mandej në publikim në ueb faqe e kështu me radhë për t'krijë plotfuqishmëri dhe zbatueshmëri të tyre.

Përveç kësaj gjatë këtij viti janë përkthyer dhe lektuar 60 vendime 5 rregullore, plane dhe strategji të aprovuara në Kuvend si dhe shumë materiale tjera të ndryshme. Janë bërë edhe shumë orë përkthim simulantë e gojor.

**STATISTIKAT:**

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	12(1 perkujtimore)	168 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	12	154 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	58	120 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	31	168 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	91	239 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	148	418 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	116	271 faqe
8.	Fotokopjimi	1190	54000 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	11	57 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	11	48 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	41	195 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS	6	34 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	82	550 faqe

14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm ( për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme ).	114	228 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	490	2470 faqe
16	Rregullore,Plan, Korniza e të ngjajshme-	5	110 faqe
17	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajshme)	317	732 faqe
19.	Gjithsejt	2735	59723 faqe
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 239 orë përkthim gojor

## SEKTORIN PËR MIRËMBAJTJE DHE OPERIM

Në sektorin për mirëmbajtje dhe operim të gjitha punët janë kryer sipas obligimeve që kemi, deri te mirëmbajtja dhe sigurimi i veturave dhe gjendjen e tyre e vazhdueshme teknike, si dhe kontrollimi i karburanteve të shpenzuara.

Të gjitha veturat janë të pajisura me pjesë kontrolluese.

## STATISTIKAT PARCIALE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator dhe mesatarja e harxhimeve	/	<b>378.64 litra.</b>
2	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	190	<b>18171.41 litra karburante</b>
3	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve	190	<b>198939 km mes; 9 lit/100 km</b>
4	Shperndarje e ftesave	40	
5	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	/	<b>3200m2</b>
6	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	2	
7	Servisimi i automjeteve	29	
8	Bartja e zyrtarve komunal ne trajnime-Prishtine me Kombi	684	
9	Vazhdimi i regjistrimit të autoemjeteve	13	
10	Kerkesa per vetura zyrtare	2050	
11	<b>Gjithsejt</b>	<b>3198</b>	

## NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE

Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kanë realizuar aktivitete të ndryshme dhe po ashtu ka qenë pjesë e debateve, takimev, tryezav dhe trajnimeve të organizuara nga institucione vendore dhe organizata ndërkombëtare.

Kemi bërë plotësimin e pyetësorit për Ministrin e Pushtetit Lokal (MAPL) me të dhëna nga fushat të Drejtave të Njeriut, Barazisë Gjinore, Komuniteteve, Drejtave të Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuara.

Është bërë shpërndarja e mjeteve didaktike për nxënësit me nevojat e veçanta për nxënësit e shkollave fillore ne Lipjan, Magurë dhe Janjevë. Ky projekt është realizua dhe mbështetur financiarisht nga zyra për barazi gjinore.

Për agjensionin për barazi gjinore plotësimi i pyetësorit për subvencionimin e fëmijëve në kopshte të fëmijëve me rastin e dhunës mbi baza gjinore ne familje për vitin 2022.

Takim pune në Komisionin për Hartimin e bazës së të Dhënave për Persona të Ndjeshëm. Ky aktivitete zhvillohet ne bashkëpunim me organizatën PIN nga kompania zhvilluese.

Plotësimi i tabelarit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor 2024 për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2025.

Takim pune të përbashkët për hartimin e planit të punës me Ekipën Komunale për të Drejtat e Fëmijëve.

Strukturimi i Komitetit Konsultativ për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Plotësimi i tabelarit me të dhëna buxhetore për vitin 2024 për kornizën afatmesme buxhetore 2024-26

Plotësimi i pyetësorit pe Integritet Evropianë

Është mbajtur takimi i dytë i Komitetit Komunal Veprues, për hartimin e Planit Lokal të Veprimit përfshirja e komuniteteve Rom dhe Ashkali te komunës së Lipjanit.

Takim pune së bashku me ekipin për përgatitjen e përfundimit të performancës komunale 2022

## Promovimi i muajit Tetor muaji për ndërgjegjësim dhe mundësi të barabarta

Me rastin e fushatës ndërkombëtare “Tetori – muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara“, në ambientet e bibliotekës së Qytetit, Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenieje Sociale s’bashkua me Njësitin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore kanë organizuar tryezë diskutimi me personat me nevoja të veçanta me qëllim të ngritjes së vetëdijes për këtë kategori të çmua të shoqërisë sonë. Të pranishëm ishin anëtarët e shoqatës Handikos dhe Organizatës Multietnike për personat me Aftësi të Kufizuara OMPAK. Komuna ka mbështetur 20 persona me aftësi të kufizuara, që të jenë pjesë e stafit Komunal për dy ditë radhazi.

Takim pune në Asociacionin e Komunave s’bashkua me kolegjiunin e zyrtarëve për barazi gjinore me qëllim të hartimit të planit njëvjeçar të kolegjiunimit.

Takim pune për finalizimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje –komuna Lipjan. Dhe përgatitjet për aktivitetet rreth 16 ditë të fushatës kundër dhunës në familje në baza gjinore

Tryezë pune për rishikimin e dokumentit kryesor të sistemit të menaxhimit të performances komunale 2022, përmes grupeve teknike për analizimin e detajuar të fushave dhe treguesve: Barazia në punësim, përfaqësimi gjinor dhe arsimim parauniverzitar.

Ky takim u organizua nga Ministria e Administrimit të pushtetit lokal(MAPL) i mbështetur nga DEMOS

Takimi parë i Komisionit komunal për Hartimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2027. Këtë projekt e mbështet Sindrom Daun Kosova –Ferizaj dhe partneret financiar UNICEF në Kosova dhe USAID.

Konferencë me temën “Personat me aftësi ndryshe pjesë pandashme e shoqërisë me rastin e 3 dhjetorit ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara ,organizuar nga Handikos dhe OMPAK Lipjan.

Përmbyllja e aktiviteteve të 16 ditë të aktivizimit me mbajtjen e sesioneve këshilluese në kuadër të dhunës në familje 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje, dhe baza gjinore u përmbyll fushat vetëdijesuse kundra dhunë në familje në baza gjinore 2023

### STATISTIKAT:

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
11	29	5	2	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 66

## DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë vitit 2023 është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kujdes Parësor Shëndetësor 2020-2024, Strategjinë dhe Planin Veprimit për Përfshirjen Sociale 2022-2024, Planin e Punës se DHSPS-së për vitin 2023 si dhe implementimin e rekomandimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kundër pandemisë Covid19.

Objektiv i përgjithshëm gjatë këtij viti ka qenë vendosja e pacientit dhe komunitetit në fokus dhe ofrimi i shërbimeve cilësore nga Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) të cilat i përgjigjen më mirë nevojave të pacientit dhe komunitetit, duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Shëndetësia në Komunën e Lipjanit është ranguar në vendin e dytë në Raportin e Performancës Komunale të publikuar në vitin 2023. Ky raport prezanton rezultatet e punës së komunave në fushën e shëndetësisë. Ky është një sukses të cilin e ka shoqëruar angazhimi dhe konsistenca e vazhdueshme drejt përmirësimit të kushteve të punës dhe të shërbimeve shëndetësore nga ana e personelit shëndetësor dhe menaxhmentit.

Vazhdimi i aplikimit të qasjes strategjike më ndryshe dhe pragmatike në vitin 2023, hartimi i një plani të veprimit si dhe hartimi i një plani të punës të thjeshtë, të matshëm dhe të realizueshëm brenda një viti kalendarik kanë rezultuar të suksesshme dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në:

- Avancimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore në kuadër të mjekësisë familjare,

- Avancimin e shërbimeve laboratorike duke bërë rritjen e numrit të analizave të ofruara në gjithsej 42 parametra dhe shkurtimin e kohës për ofrim të analizave,
- Eliminimin e kohës së pritjes në shërbimin e radiologjisë diagnostike,
- Rritjen e numrit të shërbimeve stomatologjike dhe rritjen e sigurisë gjatë ofrimit të shërbimeve,
- Rritjen e shërbimeve dhe vizitave për nënat në sektorin e maternitetit dhe gjinekologjisë,
- Avancimin dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin shëndetësor të angazhuar në ofrim të shërbimeve në institucionet shëndetësore në Lipjan dhe
- Përmirësimin e higjienës dhe avancimin e mirëmbajtjes në QKMF, QMF dhe AMF.

Në avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve të qasshme dhe më cilësore shëndetësore ka ndikuar drejtpërdrejtë përmirësimi i kushteve të punës në objektet shëndetësore si përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisja e institucioneve shëndetësore me pajisje dhe aparatura mjekësore të reja si:

- Removimi i ambienteve të brendshme të QMF-së në Gadime,
- Renovimi i katit të parë të QKMF-së, shtuarja e epoksitit,
- Ndërrimi i derës së hyrejs në QKMF,
- Renovimi tualeteve për pacient dhe personel mjekësor,
- Renovimi i këshillimores për shërbimet e integruara,
- Blerja e rëntgenit,
- Blerja e 3 makinave elektrike për pastrimin e dyshemesë në QKMF dhe QMF Gadime,
- Blerja e trakave dhe biçikletave për ushtrime fizike në këshillimoren për kujdes të integruar,
- Renovimi i infrastrukturës së jashtme në QMF Gadime dhe krijimi i parkingjeve të reja,
- Renovimi i QMF në Janjevë,
- Renovimi i AMF në Babush dhe krijimi i parkingjeve të reja,
- Blerja e dy auto veturave për bartjen e pacientëve me hemodialize,
- Sigurimi i një auto veture për shërbimet e vaksinimit dhe vizitave në terren, me frigorifer të integruar për ruajtje të vaksinave.
- Fillimi i punimeve të projektit, Ndërtimi i Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit.
- Pajisa e secilit mjek familjar dhe pajisja e shërbimit të urgjencës me çanta të kompletuara me pajisjet e nevojshme për shërbim,
- Pajisja e sektorit të Urgjencës me instrumente të mjaftueshme për pastrim lidhje,
- Pajisja e ordinancave dhe pacienteve me sëmundje kronike jongjitëse me tensimetër,
- Blerja e aparaturave biokimike dhe numëruesve hematologjik,
- Renovimi i ambienteve të rëntgenit,
- Blerja e katër karrigeve stomatologjike, dhjetë sterilizator dhe katër autoclav,
- Furnizim me gleukometër, tensimetër digjital, inventar, pajisje për aktivitet fizik dhe materiale tjera për edukim dhe promovim shëndetësor në këshillimoren e QKMF-së për shërbime shëndetësore të integruara nga AQH,
- Nga UNICEF kemi pranuar 10 tablet të cilët do të shërbejnë për personelin mjekësor të angazhuar në vizita në shtëpi dhe vizita për nëna e fëmijë deri në moshën 3 vjeçare,
- Nga UNICEF dhe Banka Raiffeisen kemi pranuar një veturë si donacion për shërbimet e Qendrës për Punë Sociale.
- Furnizimi me pajisje tjera të nevojshme për ofrim të shërbimeve cilësore.

Fokus kryesor i DSHPS-së gjatë këtij viti ka qenë riorganizimi i ordinancave dhe punës së personelit mjekësor si dhe përmirësimi i kushteve me qëllim të avancimit të shërbimeve shëndetësore në Departamentin e Mjekësisë Familjare. Në kuadër të Planit të Punës për vitin 2023 është realizuar Objektivi 1. Riorganizimi, përmirësimi i kushteve dhe avancimi i shërbimeve shëndetësore në Departamentin e Mjekësisë Familjare, nën-objektivi 1.d. Riorganizimi i ordinancave brenda QKMF-së. Me këtë riorganizim kemi krijuar hapësirë të mjaftueshme për tetë ordinanca të shpërndara në katin përdhësë dhe katin e parë. Secila ordinancë është e përbërë nga paradhoma për infermier dhe dhoma e mjekut. Kjo mundëson ambient të mirë për ofrim të shërbimeve dhe kryerjen e detyrave si për mjekun ashtu edhe për infermierin. Secila ordinancë është pajisur mirë me të gjitha instrumentet dhe pajisjet e nevojshme për dhënie të shërbimit cilësor shëndetësor.

Më tutje, fokus ka qenë fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të urgjencës duke përmirësuar kushtet e punës dhe duke furnizuar këtë shërbim me aparatura dhe pajisje të reja mjekësore dhe mirëmbajtje të autoveturave për shërbime urgjente.

Poashtu, gjatë kësaj periudhe kujdes të veçantë i kemi kushtuar avancimit të mëturjes së shërbimeve laboratorike duke funksionalizuar aparataturat e reja biokimike dhe hematologjike si dhe duke siguruar material të mjaftueshëm laboratorik. Gjaë kësaj periudhe, kemi avancuar dukshëm, dhe kemi arritë të ofrojmë 42 teste/analiza laboratorike, duke përfshirë edhe analizat HbA1c/Hemoglobina e Glikogjenizuar, AST, ALT dhe ASTO.

Është bërë pajisja e QKMF-së me Rëntgen të ri digjital. Ky shërbim ka mundësuar ofrimin e testeve radiologjike specialistike me kërkesë të mjekëve familjar, pediatri, stomatologëve dhe mjekëve të profileve tjera shëndetësore. Është punuar ngushte me shërbimin e Pneumoftizologjisë dhe Rëntgenit dhe kemi evituar radhën e pritjes për rentgen dhe ultrazë.

Në sektorin e Stomatologjisë kemi arritur të përmirësojmë kushtet e punës duke furnizuar këtë sektor me katër karrige të reja stomatologjike, dhjetë sterilizator, katër autoclav, material stomatologjik dhe pajisje e instrumente të mjaftueshme stomatologjike.

Shërbimet në Sektorin e Gjinekologjisë dhe Maternitetit janë rritur. Blerja e tavolinës gjinekologjike ka ndikuar në cilësinë e shërbimeve. Kemi punuar në fuqizimin e tri programeve në maternitet: Kujdesi për Nenat, Kujdesi në Grup në 1000 Ditët e Para dhe programit Vizitat Shtëpiake dhe ligjerata për Shëndetin dhe Mirëqenien e Nenave dhe Fëmijëve nga moshë 0 deri në 3 vjet.

Në qendër të vëmendjes së menaxhmentit ka qenë ofrimi i shërbimeve të integruara për personat e prekur me sëmundjet kronike jo ngjitesë si Diabet, Hipertension dhe Astma.

Duke marrë për bazë se preventiva, edukimi dhe identifikimi i hershëm sëmundjeve zvogëlon rrezikun për sëmundje, paaftësi dhe vdekje, gjatë këtij viti kemi intensifikuar aktivitetet tona në zvogëlimin e sëmundshmërisë përmes edukimit dhe kujdesit shëndetësor të popullatës. Janë mbajtur shume fushata vetëdijesuese.

Në mënyrë që stafi menaxherial dhe mjekësor të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore kemi fuqizuar mekanizmat e mbikëqyrjes mbështetëse dhe menaxhimit të cilësisë, jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, janë marrë masat për parandalim të infeksioneve dhe janë zbatuar nga gjithë profesionistët shëndetësor.

Largimi i mjekëve për në vendet e huaja dhe kalimi në sektorin privat është duke vazhduar. Ne kemi ndërmarrë masat e duhura duke iniciuar procedurat e rekrutimit për zëvendësimin e tyre por nëse vazhdon ky trend institucionet shëndetësore do të ndikohen negativisht.

Kemi pranuar një printer me alfabetin Braille si donacion nga organizata People in Need (PIN). Ky printer është vendosur në ambientet e administratës në katin përdhese të komunës dhe do të ju shërbej personave të verbër për marrjen e të gjitha shërbimeve të nevojshme si shëndetësore, administrative etj.

Kemi punuar ngushtë me Qendrën për Punë Sociale (QPS-në) me qëllim të identifikimit të vështirësive, sfidave dhe avancimin e mëturjes së shërbimeve sociale. Është zgjidhur problemi i transportit dhe është gjetur një zgjidhje për orët e kujdestarisë.

Aktivitetet e planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Përfshirjen Sociale 2022-2024 të aprovuar nga Kuvendi Komunal kanë filluar të implementohen.

Kemi vazhduar me masat e rekomanduara nga MSH dhe IKShPK për pandeminë Covid-19 dhe kemi krijuar kushte të përshtatshme për vaksinim si dhe për testim kundër pandemisë Covid19.

Kemi përmirësuar kushtet logjistike dhe kushtet e punës për punëtorët e Qendrës për Punë Sociale. QPS është pajisur me një veturë si donacion nga Unicef. Nga Zyra e EU është implementuar projekti për ndërtimin e ashensorit dhe tualeteve.

Gjendja në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në vitin 2023, duke përfshirë edhe shëndetin e rezidentëve, në përgjithësi ka qenë e mirë. Është bërë avancim i mëturjes së kushteve për pacient dhe punëtorët e Shëpisë me bazë në Komunitet duke siguruar kujdes, higjienë, mirëmbajtje dhe ushqim të mirë për pacientët si dhe kushte të mira për stafin.

Komiteti për Shëndetësi ka mbajtur disa takime dhe ka vizituar shumicën e QMF-ve dhe AMF-ve në terren si dhe QKMF-në. Ky Komitet ka nxjerrë një raport rreth të gjeturave dhe ka dalë me rekomandime për avancim të mëturjes së kushteve dhe shërbimeve.

## PUNËT DHE AKTIVITETE E REALIZUARA NË VITIN 2023

Me qëllim të përgatitjes për projektin e Zonimit dhe implementimit të plotë të mjekësisë familjare, gjatë kësaj periudhe kohore është vazhduar të punohet në fuqizimin e mjekut dhe infermierit më qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore për pacientin. Kemi marrë hapa konkret duke marrë vendim për riorganizimin e ordinancave. Me këtë vendim janë krijuar hapësira të mjaftueshme për katër ordinanca në katin e dytë dhe katër ordinanca në katin e parë. Secila ordinancë do të jetë e përbërë nga dy dhoma, njëra për mjekun e tjetra për dy infermier. Kartelat e pacientëve janë bartur në secilën ordinancë dhe secili pacient do të regjistrohet te mjeku i tij/saj familjar.

Avancimi i shërbimeve të cekura më lartë në përmbledhje, por jo vetëm, është bërë duke zgjeruar komunikimin me personelin mjekësor, komunikimin në mes të personelit shëndetësor dhe pacientit si dhe anasjelltas.

Në kuadër të avancimit të komunikimit jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve në përmirësimin e mëtutjeshëm të komunikimit dhe qasjes ndaj pacientit. Janë organizuar dy konsultime publike, njëri me komunitetin dhe pacientët në moshë të shtyer 65+ ndërsa tjetri me pacientet gra. Këto konsultime publike janë përkrahur nga OSCE. Qëllimi themelor i këtyre konsultimeve ka qenë identifikimi i nevojave, diskutimi i vështirësive dhe gjetja e mënyrave për të avancuar më tutje shërbimet shëndetësore.

Në këtë vit është themeluar Këshilli i Pacienteve i përberë nga pesë anëtarë. Ky këshill ka ndihmar institucionet shëndetësore në avancimin e shërbimeve shëndetësore.

Është shënuar Viti i Përsonave me Aftësi të Kufizuara. Ashensori në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan ka pasur ndikim të madh për personat me aftësi të kufizuara ngase ju ka ofruar qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore në katin e dytë dhe të tretë në QKMF.

Në bashkëpunim me AQH dhe OJQ POLIS kemi implementuar Fletë Notimin Komunitar ku janë përfshirë aktivitetet dhe masat për implementimin, monitorim dhe realizim e objektivave dhe aktiviteteve brenda afateve kohore të përcaktuara në Planin e Veprimit 2022-2024.

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim dhe jemi duke e përcjellur për së afërmi këtë proces. Përmirësimi i kushteve të punës për stafin mjekësorë dhe për pacientin si dhe ofrimi i shërbimeve adekuate është trajtuar me kujdes. Për së afërmi është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienik si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallë me carcaf të ri. Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastertinë brenda ambienteve të QKMF-së.

Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është kryer me rregull dhe me sukses, sipas kërkesave nga shefat e sektorëve, mirëpo furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk është bërë në tërësi. Furnizimi me insulinë kryesisht ka qenë i kënaqshëm ndërsa furnizimi me barna për hipertension nuk është bërë me rregull nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë, ka pasur mungesë për periudha të gjata kohore dhe kemi hasur në probleme të mëdha.

Bashkëpunimi me AQH-në rreth implementimit të planeve dhe projekteve për insitucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit ka qenë i shkëlqyeshëm.

Në këtë periudhë raportuese kemi përkrahur projektin kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeqare. Do të vazhdojmë me përkrahjen. Kemi siguruar një veturë për kryerjen e vizitave në terren.

Në majin Qershor dhe muajin Nëntor kemi bërë përgatitjet për rritjen e kapaciteteve dhe riorganizimin e punës në QKMF me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe përballje me rritjen e numrit të pacientëve si pasojë e rritjes së temperaturave dhe ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora gjatë muajve Korrik, Gusht, Dhjetor dhe Janar. Më tutje, kemi marrë vendim për ngritjen e kapaciteteve të urgjencës duke dërguar mjek dhe infermier shtesë me qëllim të mbajtjes së urgjencës në funksion dhe gatishmëri të plotë për intervenim gjatë këtyre muajve të cilët janë zoakonisht të ngarkuar.

Jemi përgatitur për të menaxhuar ikjen e mjekëve nga vendi dhe ose kalimi i tyre në biznes privat. Kemi zhvilluar me kohë procedurat e rekrutimit.



Në kuadër të riorganizimit, me qëllim të evitimit të trafikut të ngarkuar brenda në QKMF, barnatorja është zhvendosur në katin përdhësë dhe shërbimi do të ofrohet nga hyrja e veçantë.

UNICEF, përmes angazhimit të OJQ-ve lokale me bazë në komunitet, ka përkrahur sektorin e vaksinimit përmes projektit të imunizimit të fëmijëve nga komuniteti jo shumicë. QKMF, respektivisht njësia për imunizim, është duke ofruar shërbime profesionale dhe duke bërë vaksinimin e të pa vaksinuarve.

Kuvendi Komunal ka aprovuar Planin e Punës për të Drejtat e Fëmijës 2024-2026 përmes të cilit Komuna e Lipjanit ka për qëllim promovimin e të drejtave dhe mirëqenies së çdo fëmije. Ky plan do të ofrojë mundësi për të analizuar politikat ekzistuese, pasqyrimin socio-ekonomik dhe financiar për çështjet e fëmijëve, identifikoj nxitësit kryesorë të pabarazive dhe sfidat kryesore për të përmbushur të drejtat e fëmijëve dhe ofron rekomandime për zhvillimin e politikave adekuate. Komuna e Lipjanit është e angazhuar që të kontribuojë më tej në informimin dhe rritjen e llogaridhënies si dhe reagimit të institucioneve lokale ndaj të drejtave të fëmijëve dhe grave.

## QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FMILJARE – QKMF

Komuna e Lipjanit ka qenë nikoqir i ditës së tretë të Simpoziumit Ndërkombëtar tre ditor për Sëmundjet Kronike Jo-Ngjitëse të mbajtur me 27-29 Shtator 2023. Ky Simpozium është mundësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Organizimi është bërë nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe projektet e SDC-së në Kosovë AQH (Kujdesi Shëndetësor i Qashtëm dhe Cilësor) dhe IHS (Shërbimet Shëndetësore të Integruara). Në këtë Simpozium Ndërkombëtar janë prezantuar të arriturat e QKMF-së, inovacionet dhe sfidat në implementimin e shërbimeve të integruara shëndetësore, pakoja bazike si dhe telemjekësia.

### Indikatorët e performancës

18. Fusha Shëndetësia Primare				
18.1.1	m <sup>2</sup> të hapësirave KPS për 10000 banorë <b>GRANT</b>	1624.15 m <sup>2</sup>		
18.1.2	Objektet e KPS që janë të pajisura sipas udhëzimit administrativ edhe shërbimet laboratorike	2023 QKMF=100%, 4-QMF=100%, UA 04/2020		
18.2.1	Niveli i pajtueshmërisë me raportin 1 mjek familjar edhe 2 infermier për 2000 banorë <b>GRANT</b>	2023= 29 MF në Komunene Lipjanit		
18.2.2	Përqindja e buxhetit për kujdes primar shëndetësor të mbështetur nga komunat prej të hyrave vjetanake	10.38 % (242,672.82€)		
18.3.1	Numri i vizitave të pacientëve në kujdesin primar shëndetësor për kokë banori	4.2 vizita për kokë banori		
18.3.2	Fëmijët e përfshirë në programin e imunizimit	88% e fëmijëve të përfshirë 2023		
18.3.3	Ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik për gra dhe fëmijë	Realizimi 100% i vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmije deri në 3 vjeç		

## SHËRBIMET SHËNDETSORE

01	Vizita mjekësore në QKMF	112112
02	Vizita mjekësore në QMF dhe AMF	49045
03	Vizita emergjente	57363
04	Vizita stomatologjike	9620
05	Vizita gjinekologjike	4676
06	Vizita pediatrike	6103
07	Vizita pulmologjike	542
08	Vizita paliative	1482
09	Gjithsej vizita mjekësore	240943

01	Gjithsej injeksione	92552
02	Gjithsej infuzione	38878
03	Gjithsej lidhje-pastrim plage	18673
04	Gjithsej Rëntgen eksponime	5274
05	Gjithsej pacient ne laborator	24082
06	Gjithsej lindje	3
07	Gjithsej EKG	4976
08	Gjithsej vizita shtëpiake me autoambulancë	759
09	Gjithsej USG	1294
10	Rrahje	50

11	Gjithsej transport me autoambulancë	1100
12	Gjithsej Imobilizime	374
13	Gjithsej Oksigjenoterapi	1229
14	Gjithsej largim i penjve	1183
15	Gjithsej aksident trafiku	304
16	Këshillimorja	12345
17	Gjithsej vakcina	9329
18	Teste rapide me antigjen	135
19	Gjithsej vakcina COVID-19	19
20	Referime	22791
21	Inhalime	644
22	Vizita infermierike gjinekologjike	1022
23	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç	759
24	Klasa për nëna në 1000 ditët e para	318
25	Vizita në qendrën e Azilil-Magure	60
26	Vizita në qendrën e paraburgimit	83
27	Konstatim vdekje/Mortus ad latta	125
28	Thumbim nga rriqrat	128
29	Dhunë familjare	20
30	Gjithsej shërbime	238509
31	Përqindja e referimeve	9.55%

### Aktivitetet tjera të realizuara

- Realizimi i fletnotimit komunitar për herë të tretë në Lipjan me fokus për pacientet me diabet, astma dhe hipertension,
- Realizimi i Auditit dhe riauditit me përkrahje të AQH-së dhe rishqyrtimi kolegjial, me fokus në analizimin e referimit në shërbimin e diagnostikës si laborator dhe rëntgen. Përshkrimi i antibiotikëve tek gjendjet gripoze, raportimi i semundjeve masovike kronike jo ngjitëse, sëmundjeve ngjitëse infektive dhe kancerogjene,
- Plotësim dhe furnizim me glikometër, tensiometra digjital, inventar, pajisje për aktivitet fizik dhe materijale tjera për edukim dhe promovim shëndetësor në Këshillimoren e QKMF nga AQH-projekti për shërbime shëndetësore të integruara,
- Broshura për njoftimin e qytetarëve lidhur me KPSH dhe shërbimet të cilat ofrohen në këto institucione, për edukim lidhur me përdorimin e kripes dhe sheqerit, diabetin dhe hipertensionin etj. Donacion nga AQH,
- Shënimi i ditëve botërore të Diabetit dhe Hipertensionit në përkrahje të AQH-së në sheshin e qytetit të Lipjanit dhe në komunitet,
- Pjesmarrje në Konferenca dhe Seminare në Zvicërr- Universitetin e Luganos dhe në Konferencen nderkombetare të Kujdesit Parësor Shëndetësor në Bruksel-Belgjikë, trajnime Online dhe pjesmarrje fizike për EKG, Menaxhimin e infeksioneve, dhe komunikim me pacient, 50% e stafit të QKMF-së.
- Organizimi i vizitave dhe aktiviteteve në natyrë me moshat 65+ vjeç në kuadër të zhvillimit të shërbimeve shëndetësore të integruara,
- Tryeza të rrumbullakëta me palë të interesit të organizuara nga DSHPS lidhur me identifikimin e nevojave të pacientëve, punëtorëve shëndetësor dhe institucioneve,
- Takime pune dy ditore në Brezovicë dhe Prevallë me përkrahje të AQH-së lidhur me implementimin e shërbimeve shëndetësore të Integruara.

### Burimet njerëzore

Është bërë plotësimi i pesë konkurseve për plotësimin e vendeve të punës në KPSH në Komunën e Lipjanit ku gjithsej janë rekrutuar 22 pozita , nga të cilët 4 mjekë/e dhe 18 infermier/e).

Në këtë periudhë kohore janë pensionuar gjithsej dhjetë punëtor, nga të cilët 4 Mjekë (1 gjinekolog, 1 stomatolog dhe 2 mjek familjarë), 1teknik laborator, 3-punëtor administrate (mirëmbajtje) dhe 2 infermier.

## Departamenti i Mjekësisë Familjare

Puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë, mbulimi i shumicës së punkteve ka qenë i mirë, përveç gjatë sezonit të verës dhe fundit të vitit, kur numri i pacienteve rritet dhe stafi shfrytëzon pushimin vjetor dhe nuk mund të mbulohen të gjitha punktet shëndetësore.

Në vitin 2023 jemi përzgjedhur një ndër katër komunat për projektin e Zonimit nga MSH. Me implementimin e këtij projekti, koncepti i mjekësisë familjare do të implementohet në tërësi.

Në mbështetje të avancimit të mëtutjeshëm të cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe rritjes së saktësisë, është adresuar objektivi specifik 1. Deri në vitin 2024 e gjithë infrastruktura dhe pajisjet mjekësore në IKPSH e kompletuar për të ofruar shërbime shëndetësore të qasshme dhe cilësore, pajisje dhe aparatura të mjaftueshme mjekësore, si dhe nën-objektivi 1. i. Blerja e aparaturave mjekësore nga Plani i Punës për vitin 2023. Në kuadër të kësaj, sektori i Laboratorit, Stomatologjisë, Gjinekologjisë, Urgjencës, Radiologjisë dhe sektorët tjerë janë furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja shëndetësore të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara, saktësi dhe shkurtim të kohës së pritjes.

Higjiena dhe mirëmbajtja në institucione shëndetësore ka arritur në nivelin e duhur, do të angazhohemi që të sigurojmë qëndrueshmëri. Me synim që të avancojmë shërbimet e mirëmbajtjes dhe higjienës në QKMF dhe institucionet tjera shëndetësore në Komunën e Lipjanit, në këtë periudhë kohore për të cilën po raportojmë kemi adresuar nën objektivin 1.b. Përmirësimi i ambienteve të punës dhe përmirësimi i higjienës në ambientet e QKMF-së. Kemi kryer inspektime të rregullta në ambientet në QKMF. Jemi takuar me menaxhmentin e QKMF-së dhe kemi diskutuar standardet dhe kërkesat e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale rreth higjienës dhe mirëmbajtjes. Në takime po ashtu kemi diskutuar, nevojat, vështirësitë dhe sfidat të cilat burojnë për shkak të numrit të madh të pacientëve të cilët frekuentojnë ambientet shëndetësore.

Me qëllim të menaxhimit më të mirë të sistemit të radhës dhe kohës së pritjes për të marrë shërbimet mjekësore në QKMF, kemi punuar në objektivin nr.1. Riorganizimi, përmirësimi i kushteve dhe avancimi i shërbimeve shëndetësore në Departamentin e Mjekësisë Familjare, nën objektivi 1.a. Implementimi i sistemit elektronik të pritjes së radhës. Ky projekt, përveç programit me specifikat e QKMF-së në Lipjan, përfshinë edhe furnizimin me display orientues digjital të cilët janë vendosur mbi secilën derë të secilës ordinancë dhe një display të madh në hyrje të QKMF-së.

Më tutje, me qëllim të organizimit më të mirë të punës dhe shërbimeve mjekësore, jemi fokusuar në implementimin e nën objektivit 1.c. Implementimi i SISH-it dhe kartelës elektronike të pacientit. Edhe përkundër problemeve teknike si rënia e kohëpaskohshme e serverit të SISH-it në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rrjetit, është shënuar një rritje e lehtë në përdorimin e Sistemit Informativ Shëndetësor SISH.

Webfaqja për QKMF, e financuar nga AQH, është aktivizuar dhe ka funksionuar mirë. Kështu kemi adresuar objektivin 1.f. Zhvillimi dhe implementimi i kutisë elektronike të ankesave në QKMF, QMF, AMF dhe urgjence. Jemi pajtuar që ky funksion të përfshihet në webfaqen e QKMF-së dhe të monitorohet nga menaxhmenti i QKMF-së dhe DSHPS-së.

Ka filluar të implementohet pilot projekti i Telemjekësisë në AMF Kraishtë. Komuna e Lipjanit është e para në nivel vendi në ofrimin e shërbimeve mjekësore përmes telemjekësisë.

Përkrahja nga AQH në këtë vit ka qenë e shkëlqyeshme dhe është shtrirë në disa fusha si: Kujdesi i integruar, menaxhimi cilësor i shërbimeve, komunikimi me pacient, investime kapitale, formimi i këshillit të pacienteve, etj. Po ashtu, me AQH-në kemi mbajtur takime për zbatimin e projektit Qendrat Demonstruese në QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë. Në kuadër të edukimit dhe promovimit të shëndetit janë organizuar një sërë aktivitetesh:

- Janë shënuar edhe shumë ligjërrata dhe aktivitete tjera për Ndërgjegjësimin për Kancerin e Gjirit për muajin Tetor 2023. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë shume gra dhe akter të ndryshëm relevant.
- Gjatë muajit Tetor, është arritur marrëveshje me Komunën e Prishtinës për ofrimin e shërbimit të mamografisë falas për gratë e Lipjanit. Në kuadër të marrëveshjes është përfshirë ofrimi i shërbimeve të mamografisë gjatë muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të këtij viti. Komuna e Lipjanit, respektivisht QKMF ka organizuar transportin për të gjitha gratë e interesuara për këtë shërbim. Transporti është organizuar nga QKMF Lipjan në QKMF të e caktuara në Prishtinë.

Më tutje, Komuna e Lipjanit është përfshirë në planin e Sektorit të Radiologjisë në QKUK për sjelljen e Mamografit Mobil në kohëzgjatje prej tre ditëve gjatë muajit Tetor.

- Me përkrahjen e OSBE-së janë mbajtur dy tryeza me gratë e Lipjanit dhe gratë e angazhuara në shërbime shëndetësore. Në këto takime janë dhënë ligjërata rreth kancerit të gjirit dhe janë diskutuar nevojat për avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore.
- Në kuadër të ZHVP-së është majtë shënimi i ditës kundër TB më 24 Mars 2023, si dhe me rastin e shënimit të ditës së shëndetësisë në muajin Prill kemi mbajtë një ligjëratë me qytetarë të Komunës së Lipjanit ku janë njoftuar me strukturën organizative, shërbimet e KPSH, sasinë dhe cilësinë e shërbimeve si dhe vështirësitë tona dhe të qytetarëve në ofrimin dhe marrjen e shërbimeve shëndetësore në KPSH.
- Dita Botërore e Zembrës, me përkrahje të AQH-së. Ky aktivitet është mbajtur në Sheshin Adem Jashari dhe në lagjen të Xhamia.
- Dita botërore kundër diabetit më 14 Nëntor 2023, organizuar në Sheshin Adem Jashari dhe në lagjen të Xhamia.
- Dita kundër HIV/AIDS, 1 Dhjetor 2023.
- Ligjërata me qytetar/pacient nga OJQ KOPF në AMF Kreishtë, me banorë nga Ribari i Madh dhe Kreishtë, në Magure, Shalë dhe Gadime etj.
- Janë mbajtur 10 ligjërata të EVP të akredituar nga Oda e mjekëve të Kosovës.
- Organizimi i mbajtjes së Simpoziumit ndërkombëtar i sëmundjeve kronike jo ngjitëse, ku dita e tretë është mbajtur në sallën e Kuvendit në Lipjan. Ky Simpozium është mbështetur nga AQH dhe SDC. Përveç simpoziumit, janë organizuar aktivitete dhe vizita në QMF-Gadime, karvani PërShndetje i implementuar nga OJQ KOPF, vizita në parkun Nacional Blinajë për pacientët me sëmundje kronike të zembrës, etj.
- Pjesëmarrja e stafit superior dhe të mesëm në kongrese dhe trajnime është përkrahur nga menaxhmenti.
- Këshillimorja e re në lokacionin e ri brenda QKMF-se është pajisur me pajisje të lehta për fitnes. Pajisjet janë lëshuar në përdorim dhe pacientet me sëmundje kronike jo ngjitëse mund të i shfrytëzojnë. Ambienti i tanishëm ofron kushte më të mira për ofrim të shërbimeve të integruara, këshilla dhe ligjërata për pacientet geriatrik 65+ me sëmundje kronike jo ngjitëse.

## Sektori i Infermierisë

Në sektorin e infermierisë është arritur koordinim i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve gjatë pandemisë, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës. Kemi bashkëpunuar ngushtë në përmirësimin e cilësisë së punës në bashkëpunim me drejtorinë dhe koordinatoren e QEV-it. Po ashtu, janë organizuar planifikim i trajnimeve të stafit dhe shënimi i ditëve të caktuara në shëndetësi. Ky shërbim ka bartur punën e kryerjes së stazhit të gjithë praktikantëve të infermierisë, mbi 300 praktikant/e.

## Shërbimi i Urgjencës

Shërbimi i urgjencës në QKMF ofron shërbime 24 orë në ditë dhe është duke vazhduar të përmirësohet dukshëm. Ky shërbim është fuqizuar shumë me resurse njerëzore dhe tani stafi i Urgjencës përbëhet nga 9 mjek dhe 16 Teknik/Infermiere si dhe njësia e transportit me nga 1 vozitës për çdo ndërrim (4 ndërrime), me pajisje dhe automjete për intervenim të shpejtë.

Është implementuar Objektivi 1. i Planit të punës për vitin 2023 Fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të urgjencës, nen-objektivi 1.e) Respektimi i orarit të punës përmes implementimit të sistemit të monitorimit 1.g) Caktimi i personave përgjegjës në secilin ndërrim për përgatitjen e autoambulancave për ekipet e intervenimit dhe 1.i) Prokurimi i një autoambulance për ndërhyrje të shpejta.

Më tutje, edhe pse objekti i Shërbimit të Urgjencës është në gjendje të rëndë, është punuar në përmirësimin e ambienteve dhe kushteve të punës duke e pajisur këtë shërbim me inventar të ri.

Planifikimi dhe mobilizimi me kohë për përballim të numrit të madh të pacientëve gjatë ardhjes në pushim të mërgimtareve në sezonin e verës dhe gjatë festave të fund vitit ka dhënë rezultate të mira. Kjo qasje ka rezultuar e suksesshme ngase ky vit ka qenë ndër vitet e pakëta që nuk është përcjellë me probleme gjatë këtyre periudhave kohore të lartshënuara.

Në shërbim të Urgjencës gjatë një ndërrimi janë nga dy mjek për arsye të vëllimit të madhe të punës brenda dhe krijimi i mundësisë së daljes në teren. Ky shërbim është i ngarkuar me numër të madh të pacientëve, si rrjedhojë edhe shpenzuesi i më shumë se gjysmës së furnizimit me material mjekësor dhe terapi.

### **Sektori i Laboratorit**

Disponojmë aparatura të mira dhe plotësojmë kriteret nga UA 04/2020 për KPSH. Shërbimi i Laboratorit ka filluar të ofroj të gjitha analizat, 42 analiza, siç specifikohet me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet administrative për kujdesin parësor shëndetësor UA 04/2020. Për të krijuar këtë mundësi, laboratorit është pajisur me aparataturat e nevojshme shëndetësore bashkëkohore si: aparat biokimik, numërues hematologjik, mikroskop, dhe aparatura tjera për nevoja të këtij shërbimi si në QKMF ashtu edhe në punkte. Kjo aparaturë e mirë tani ka mundësuar ofrimin e analizës HbA1c/Hemoglobina e glikogjenizuar. Gjate vitit nuk kemi pasur vështirësi në furnizim me material laboratorik dhe kemi shtuar edhe 4 analiza në këtë sektor.

### **Sektori i Radiologjisë Diagnostike**

Kemi eliminuar nevojën për pritje për shërbime të rëntgenit në sektorin e Radiologjisë. Përmirësimit të sektorit të radiologjisë diagnostike dhe shërbimeve laboratorike i jemi adresuar duke vendosur komunikim të drejtpërdrejtë me këtë sektor, objektiv 4. Përmirësimi i shërbimeve në sektorin diagnostikues, laborator dhe rëntgen. Gjatë takimeve kemi identifikuar gjendjen e pajisjeve dhe aparatrave mjekësore, kemi identifikuar nevojat për aparatura shtesë dhe kemi siguruar një rëngën digjital i cili ka hyre në funksion këtë vit. Në Shërbimin e Radiologjisë diagnostike në QKMF do të kemi mundësi të ofrojmë teste radiologjike specialiste me kohë sipas kërkesave të mjekëve familjar, pediatri, stomatologeve dhe mjekëve të profileve tjera shëndetësore.

### **Sektori i Stomatologjisë**

Në sektorin e stomatologjisë nga fundi i këtij viti kemi arritur të ofrojmë pakon me shërbimet e kompletuara stomatologjike duke filluar nga fotografimi, shërimi, mbushja, nxjerrja e dhëmbit dhe pastrimi. Ky përmirësim në këtë sektor është arritur duke bërë riorganizimin e stafit dhe përmirësimin e kushteve të punës. Sektori i Stomatologjisë është pajisur me katër karrige të reja stomatologjike, rëntgenit të dhëmbëve, katër autoclav dhe 10 sterilizator.

### **Sektori i Maternitetit**

Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani janë orientuar drejt vizitave gjinekologjike-obstetrike, vizitave shtëpiake dhe këshillave për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, po ashtu edhe klasa për nëna. Vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Pajisja me karrige për ekzaminim, me sonda të reja për ECHO dhe aparat CTG ka përmirësuar dukshëm kushtet e punës.

### **Shërbimi i Pneumoftizilogjisë**

Është shënuar rritje e numrit të sëmurëve me TB. Gjithsej janë evidentuar 43 raste, tri raste me shumë se në vitin 2022. Shërbimi funksionon pa ndonjë ndryshim të veçantë.

### **Sektori i Vaksinimit**

Përveç realizimit të vaksinimit sipas planifikimit kemi zhvilluar një fushatë vaksinimi në komunitetin Ashkali, romë dhe egjiptian në bashkëpunim me UNICEF dhe OJQ „Sun Flowers”. Deri më 31.10.2023 janë vaksinuar fëmijët e të gjitha moshave të cilët nuk kanë qenë të vaksinuar. Deri më 31.12.2023 janë 2600 vakcina të aplikuara kundër gripit sezonal,

### **Sektori i Barnatores**

Kemi një përmirësim në shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Furnizimi me barna është bërë sipas planifikimit të gjashtë muorit të parë, dhe gjashtë muorit të dytë për çdo muaj sipas kërkesës. Jemi furnizuar mirë me Insulina dhe nuk ka pasur mungesë për pacientët. Ndërsa me material shëndetësor kemi qenë të furnizuar pjesërisht. Me barna tabletare furnizimi nuk ka qenë i dobët ndërsa ka munguar furnizimi me terapi ampulare. Shefi i barnatores ka nxjerrë një përqindje të furnizimit

në bazë të numrit të artikujve që jemi furnizuar, e që nuk është pasqyrë plotësisht real për arsye se disa artikuj janë më të domosdoshëm dhe disa tjerë me pak. Nga vlerësimi i i furnizimit sipas numrit të artikujve (172 artikuj) nga lista esenciale furnizimi ka qenë 67.55%, kurse me insulinë ka qenë 100%.

## Departamenti i Administratës

Nr.Rend	Emërtimi i Aktit	Nr. i aktive
1	Aktvendime për shfrytëzim të pushimeve vjetore	236
2	Aktvendime për pagesën e punës së nates, jashtë orarit, festave, etj.	33
3	Aktvendime mbi masat disiplinore/Vërejtje	00
4	Lëshime të vërtetimeve për provojë të punës për ish-punëtorë dhe punëtorë aktual	35
5	Evidentimi dhe procedimi i pushimeve mjekësore	60
6	Evidentimi dhe procedimi i lindjeve në njësinë e maternitetit	3
7	Aktvendimet për pushimet e lehonisë për punëtorët	3
8	Largim nga puna me vetë dëshirë dhe të larguar me procedurë të rregullt	2
9	Pushimet pa pagesë	8
10	Rekrutime të reja të punëtorve	26
11	Vertetime që kanë përfunduar praktikën në QKMF	120
12	Vërtetime që kanë qenë në praktikë vullnetare në QKMF	5
13	Akvendime për daljen në pension të punëtorve	10
14	Akvendime për nderprerjen e punës së punëtorve që kanë vdekur	00
15	Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme	40
16	Ndryshime në listen e pagave të punëtorve për vitn 2023	240
17	Pregaditja e pageses për shtesat Covid-19	00
18	Pregaditja e Autorizimeve për praktikë	350
<b>Gjithsej:</b>	<b>Totali i lëndëve</b>	<b>1,136</b>

## Sektori i Mirëmbajtjes

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është bërë avancim i theksuar. Është shënuar përparim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve.

## Sektori i Autogazhës

Pas furnizimit me vetura të reja për shërbime shëndetësore në KPSH është përmirësuar shumë shërbimi i transportit me autoambulanca dhe pacientëve në hemodializë, vizitave në shtëpi, kujdes paliativ. Është shënuar rënie e shpenzimeve të derivateve. Kemi edhe një orar të ri me pacientet e hemodializës si dhe shtim të pacientëve të ri. Është formuar komisioni për vërtetimin dhe evidentimin e shpenzimeve të derivateve në automjetet e QKMF-së. Servisimi është bërë me kohë i të gjitha automjeteve të QKMF-së.

## Konkluzione

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Primar shëndetësor në komunën e Lipjanit përkundër vështirësive me pandeminë, si dhe vaksinimin kundër gripit sezonal, është arritur një besueshmëri nga qytetarët/pacientët ku dëshmohet me numrin prej 479,452 vizita mjekësore dhe shërbime shëndetësore.

Nga anketimi i kryer nga PRAK, ka dal rezultat se kënaqshmëria e pacientëve/qytetarëve të cilët marrin shërbime në KPSH-Lipjan është 66%. Nga kjo anketë kemi kuptuar se kënaqshmëria me shërbime shëndetësore dhe stafin mjekësorë është mbi 85%, por te furnizimi me barna nga lista esenciale kënaqshmëria është më e ulët (ky furnizim kryhet nga MSh). Si total përqindja 66% është një vlerësim i cilësuar nga PRAK si vlerësim shumë i mirë.

## QEBDRA PËR PUNË SOCIALE – QPS

Qendra për Punë Sociale është i vetmi institucion publik me kompetencë profesionale si pikë referimi dhe menaxhimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për individët dhe familjet në nevojë për mbështetje materiale dhe profesionale në kuadër të shërbimeve sociale dhe familjare.

Në vazhdimësinë e aktiviteteve për ofrim sa më efikas dhe cilësor të shërbimeve për qytetarët në nevojë, Qendra për Punë Sociale realizoi aktivitete në harmoni me legjislacionin, standardet, procedurat administrative dhe politikën sociale, përfshirë:

Avancimin e kornizës organizative dhe administrative përmes plotësimit të standardeve strukturore, (infrastruktura PAK, numri i punonjësve) në kuadër të kornizës organizative të QPS-ës.

Aktivitet rreth projektit “EU For ALL” iniciuar dhe mbështetur nga Zyra e BE në bashkëpunim me MAPL, për krijimin e qasjes infrastrukturore të personave me aftësi të kufizuar në kuadër të QPS-ës. Projekt ky në vlerë prej: 105.762.00€.

Aktivitet me UNICEF dhe DSHPS në mbështetje të QPS-ës me Veturë të tipit: Shkoda, donacion nga “Raiffeisen Bank”, negociuar nga UNICEF për QPS-ën Lipjan/2023.

Mbështetja e kapaciteteve me teknologji informative, kompjuter të ofruar për SHMS nga DPSF në bashkëpunim me QPS

Aktivitet kordinues dhe bashkërendues në realizimin e objektivave të parapara në implementim të strategjisë për shërbime sociale dhe familjare, mbështetur nga “People in Need” për 2023.

Realizim i aktiviteteve në Lipjan dhe bashkësi lokale të Lipjanit, kundër dhunës në familje; siguria, prona, buxhetimi, barazia gjinore dhe lidhshipi organizuar nga KKMVDHFBGJ, OSBE, YAHR. Women for Women.

Aktivitet ekipor për mbrojtjen e fëmijëve në kuadër të tryezës për menaxhimin e rasteve/ fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë sipas Memorandumit. Mirëkuptimit lidhur ndërmjet Komunës së Lipjanit me Organizatën, ‘Terre des Homes’.

5.	Kërkesë për ndryshim adrese	34
6.	Shtim i njësisë biznesit	26
7.	Vërtetim që posedon biznes	16
8.	Shuarje të biznesit	18
9.	Shtim i aktivitetit të biznesit	29
10.	Informatat e bizneseve	250
11.	Ndrrim i pronarit	30
12.	Ndryshim emrit të biznesit	18
13.	Kërkesë për ndryshim kapitali	16
14	Ndrrim i tipit biznesit	24
	Lëndë të regjistruara në portokol gjithsejt nga Janar – Dhjetor 2023	1366

## Memorandumet e nënshkuara në kuadër të Departamentit për Ekonomi dhe Zhvillim

1. Memorandum Bashkëpunimi në mes Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik PREDA Plus, WEntrepreneur dhe K.K.Lipjan, me nr.ref.1-115/01-12725 i datës 13.03.2023.
2. Memorandum Bashkëpunimi në mes Help-Hilfe zur Selbsthilfe e.V. dhe K.K. Lipjan nr.ref.1-300/01-16009 i datës 30.03.2023.
3. Memorandum Bashkëpunimi në mes Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë dhe K.K.Lipjan me nr.ref.1-330/01-34003 i datës 04.07.2023.
4. Kontratë për zbatimin e procedurës të vlerësimit të qeverisjeve lokale dhe çertifikimit me mjedis të favorshëm biznesi (BFC SEE) dhe K.K.Lipjan, me nr.ref.1-370/03-34257 i datës 05.07.2023.

### TAKIME TJERA

Kemi mbajtur takime të ndryshme me donatorë dhe organizata ndërkombëtare e vendore si: Banka Botërore, UNDP, ASB, Preda Plus, USAID, Help Kosova, SWISS Contact, D&D bussines support center, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë si dhe shumë organizata tjera partnere rreth zhvillimit ekonomik në sektorë të ndryshëm si dhe takime me përfaqësues të bizneseve.

## DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

### PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

DPUMM gjatë vitit 2023 ka kryer detyrat e caktuara me përgjegjësi dhe në përputhje me Planin vjetor të punës. Angazhimi i Drejtoratit ishte në realizimin e të gjitha objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara. Arritjet më të mëdha ishin në fushën e planifikimit hapësinor, hartimit të dokumentacionit teknik për projektet infrastrukturore, si dhe shqyrtimi i kërkesave të palëve për çështje të ndryshme urbane.

Në kuadër të këtyre angazhimeve themelore, duhet veçuar:

- Zhvillimi i procesit të tri fazave (nga 4 gjithsejtë) të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën tetë (8) vjeçare 2023-2031;
- Hartimi i Raportit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të PZHK-së dhe dorëzimi në MMPHI për marrjen e pëlqimit;
- Hartimi dhe miratimi i Raportit vjetor për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës si dhe njoftimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktursë.

Në vitin 2023 janë pranuar 679 lëndë dhe 138 ishin të bartura nga viti praparak. Nga gjithsejtë 817 lëndë, janë shqyrtuar 713 lëndë, kurse barten në vitin 2024 - 104 lëndë të natyrave të ndryshme.

- Lansimi i "Hartës dixhitale" ku DPUMM ka bartur barren kryesore. Megjithatë gjatë vitit 2023 nuk kemi arritur t'i përmbushim të gjitha aktivitetet e planifikuara. Edhe pse kemi shënuar një rritje të lehtë të numrit të kërkesave të shqyrtuara krahasuar me një vit më parë, megjithatë numri i kërkesave të bartura ende është i lartë.

Në aspektin e realizimit të të hyrave kemi tejkaluar të gjitha parashikimet, kurse sa i përket shpenzimeve kemi pasur ca vështirësi për shkak të vonësive në realizim të detyrave, përkatësisht dështimit të projekteve në ca raste.

### REALIZIMI I OBJEKTIVAVE DHE AKTIVITETEVE TË CAKTUARA

Bazuar në Planin e punës së DPUMM për vitin 2023, veprimtaria e DPUMM ishte e orientuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore nga fusha e planifikimit, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

## OBJEKTIVAT NË NIVEL TË PËRGJITHSHËM TË DPUMM-SË

Në kuadër të objektivave të përgjithshme janë realizuar aktivitetet si:

- Hartimi i Planit të Punës për vitin 2023
  - Hartimi i Raportit Vjetor të Punës për vitin 2022,
  - Hartimi i raporteve mujore të punës dhe raportit gjashtë mujor;
  - Përgatitja dhe miratimi në Kuvend i Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës;
  - Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve dhe informacioneve të tjera për MMPHI, ASK, DEMOS, UNDP, OSBE dhe plotësimi i Raportit për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda evropiane.
  - Aktivitetet administrative në kuadër të procesit të shpronësimit të pronave për realizimin e projekteve me interes publik, duke përfshirë rrugën “Bashkim Krasniqi” dhe Inicimi/ zhvillimi i procedurave për shpronësim për procesin e implementimit të projektit Parku qendror dhe parking nentokesor i qytetit.
  - Pjesëmarrja e punonjësve të DPUMM-së në disa komisione të ndryshme dhe grupe punuese.
- Hartimi i propozim akteve për shqyrtim dhe miratim nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi:
- Trajtimi i lokacionit për kategoritë e dala nga lufta.
  - Vlerësimi i rezultateve vjetore në punë për personelin e DPUMM-së.

## OBJEKTIVAT VJETORE NË KUADËR TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Në kuadër të objektivave vjetore të planifikimit hapësinor janë realizuar aktivitetet si në vijim:

- Planifikimi hapësinor;
- Infrastrukturës rrugore;
- Infrastrukturës teknike – mjedis; dhe
- Infrastrukturës shoqërore/sociale.

Në kuadër planifikimit hapësinor duhet veçuar aktivitetet themelore si:

Monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale të Komunës. Hartimi dhe miratimi i Raportit monitorues për periudhën 2 korrik 2022 deri me 3 korrik 2023 për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara me HZK dhe njoftimi i MMPHI me këtë Raport.

Procesi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZH) për periudhën 2023-2031. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar aktivitetet si vijon:

- Është finalizuar Faza e Profilit Komunal dhe Vlerësimi i gjendjes ekzistuese, si dhe është zhvilluar procesi i shqyrtimit publik.
- Është zhvilluar punëtore 3 ditore e punës mbështetur nga USAID - Faza III, Korniza e Zhvillimit Hapësinor
- Është zhvilluar Faza e I-rë -Diskutim publik “Korniza e Zhvillimit Hapësinor” – Vizioni dhe Skenaret e propozuar hapësinor.
- Është finalizuar Draft i PZH-së
- Është finalizuar Draft Raporti i VSM-së për PZH-në dhe është proceduar në MMPHI për shqyrtim dhe miratim.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera të realizuara përfshihen:

- Hartimi i detyrave projektuese për projektet e ndryshme infrastrukturore. Në këtë kontekst DPUMM në bashkëpunim me drejtoratet përkatëse dhe kompaninë projektuese ka finalizuar gjithsejtë 29 projekte komunale të fushave si:
  - Infrastrukturë rrugore -11 projekte;
  - Nga fusha e infrastrukturës - mjedisit – 3 projekte;
  - Infrastrukturë shoqërore/sociale - 15 projekte.

Të gjitha projektet janë dorëzuar dhe proceduar për zbatim pranë Drejtorateve përkatëse. Në proces të hartimit aktualisht janë edhe 17 projekte, për të cilat kërkesat janë dorëzuar në vitin 2023.

Aktivitetet themelore të zhvillura gjatë vitit 2023 paraqiten në tabelën në vijim:



Nr.	Aktiviteti	Emri i projektit	Lokacioni	Të arriturat
<b>DOKUMENTE PLANORE</b>				
<b>A</b>				
1.	Procesi i hartimit të PZHK-së	Plani Zhvillimor i Komunes	DPUMM	Draft PZHK
		Hartimi i Raportit të VSM për PZHK –në	DPUMM	Draft VSM PZHK / dorëzuar në MMPHI
<b>B. INFRASTRUKTURË RRUGORE</b>				
1.	Hartimi i dokumentacionit teknik	Asfaltim i rrugicave në lagjet e vendbanimeve:	Shalë, Resinoc, Baicë, Ribar i Madh, Bujari, Dobrajë e Madhe,	Finalizuar
2.		Ndriçimi publik	Grackë e Vjetër	finalizuar
3.		Rrjeti energjetik për kalldajat në QPS - Lipjan	Lipjan	finalizuar
4.		Qendra “ Paragliding Lipjan “	Mirenë	Projekt Ideor
5.		Parku Qendror, Parkingu nëntokësor, Nenkalmi dhe Sheshi i qytetit	Lipjan	finalizuar
6.		Infrastruktura Faza IV në Zonë ekonomike	Qylagë	Në proces
7.		Vlerësimi i gjendjes dhe rindërtimi i fushave të futbollit	Magurë dhe Dobrajë	Në proces
8.		Ndërimi i urave	Leletiq, Banullë, Janjevë, Hanroc, Rubovc, Vrellë e Gadimes, Gadime	Në proces
9.		Rikonstruimi i rruges “Kreshnik Vishesella”	Ribar	Në proces
10.		Rikonstruimi i rruges “Ajet Kozhani “	Ribar i Madh -Poturoc	Në proces
11.		Ndriçimi publik	Zllakuqan	Në proces
12.		Ndriçimi publik i rrugëve “Afrim Zhitia” dhe “Sadik Shala”	Lipjan	Në proces
13.		Ndriçimi Publik	Varigoc	Në proces
14.		Rrjeti i kanalizimit dhe asfaltimi i rrugicave	Kleçkë	Në proces
<b>C. INFRASTRUKTURË TEKNIKE - MJEDIS</b>				
1.	Hartimi i dokumentacionit tek.	Rregullimi i përrockes	Medvec	Finalizuar
2.		Rregullimi i HHP , dhe rrenimi i ndërtesave ekzistuese të AKP	Magure	Në proces
3.		Ndërtimi i ujësjellësit në Vendbanimin Vrellë e Goleshit dhe Ndërtimi i gypit furnizues Gllavicë dhe Babush.	Vrellë Babush	Finalizuar
4.		Rrjeti i kanalizimit lagjja “Zeneli”	Mirenë	Në proces
5.		Rrjeti i ujësjellësit në disa zona	Lipjan dhe Sllovi	Në proces
<b>D. INFRASTRUKURË SHOQËRORE - SOCIALE</b>				
1.	Hartimi i dokumentacionit teknik	Renovimi i ndërtesave Shkollore në vendbanimet: Rufc i Ri, Topliqan, Janjevë, Medvec, Kojskë, Shalë, Sllovi.	Rufc i Ri, Topliqan, Janjevë, Medvec, Kojskë, Shalë, Sllovi.	Finalizuar
2.		Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare dhe Urgjente	Lipjan	Finalizuar
3.		Rregullimi parterit ne shkollen “Kadri Beba”	Ribar i Madh	Finalizuar
4.		Rregullimi i kulmit te demtuar ne shkollen “Ernest Koliqi”	Babush i Muhaxherëve	Finalizuar
5.		Sanimi i Murit tek objekti banimor – Sheshi	Lipjan	Finalizuar
6.		Sanimi i kulmit ne objektin “Shpresa”	Lipjan	Finalizuar
7.		Renovimi i objektit publik P+0 ne Lipjan	Lipjan	Finalizuar

## OBJEKTIVAT VJETORE NË FUSHËN E URBANIZMIT

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga palët, si dhe ka kryer aktivitete të tjera të caktuara.

Nga viti 2022 në vitin raportues janë bartur 138 lëndë, kurse gjatë vitit 2023 janë pranuar edhe 679 lëndë të natyrave të ndryshme. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve prej 817 janë shqyrtuar 713 apo 87.27%. Prej tyre janë miratuar jane gjithsejtë 476 lëndë, te refuzuara 128, të pezulluara 23, te ceduara 88, ndërsa 104 barten në vitin 2024, prej tyre 73 në proces të legalizimit.

Janë lëshuar 47 Leje ndertimi të kategorisë së II-të (Ndërtesa banimi në bashkëpronësi, objekte afariste, Infrastrukturore etj.) dhe 48 leje ndërtimore të kategorisë së I-rë (shtëpi banimi, objekte afariste, infrastrukturore etj.).

Në vitin 2023 lejet ndërtimore për kategorinë e II-të janë lëshuar në numër tejet të lartë të shënuar ndonjëherë. Ndërtimi i këtyre objekteve dhe popullimi i tyre do të ketë ndikim të theksuar në numrin e përgjithshëm të banorëve në qytetin e Lipjanit. Si rrjedhojë e kësaj, nevojat për infrastrukturore dhe shërbime publike janë në rritje të jashtëzakonshme, duke përfshirë sidomos nevojat për hapësirë shkollore, rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit, parkingjeve etj. Me një trend të tillë të ndërtimeve, proporcioni

i nevojave të banorëve dhe kapaciteti i shërbimeve publike do të theksohet drastikisht. Ndërlidhur me këte, vlerësojmë se duhet analizuar dhe përcaktuar prioritet e trendeve zhvillimore të infrastrukturës dhe shërbimeve publike në qytetin e Lipjanit. Po ashtu prej 139 kërkesave për kushte ndërtimore janë lëshuar 77 akte për caktimin e Kushteve ndertimore, 43 janë refuzuar, kurse në procedurë janë 8 kërkesa.

Aktivitet i veçantë i zhvilluar gjatë vitit 2023 (për herë të dytë me radhë), ishte hartimi dhe miratimi i Raportit vjetor për Monitorimin e Zbatimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) për periudhen një vjeçare. Sipas Ligjit për Planifikimin Hapësinor, ky Raport është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe pastaj iu ka dërguar MMPHI për njoftim. Në Raport është dhënë vlerësimi për nivelin e zbatueshmërisë së HZK dhe janë prezantuar sfidat që e kanë përcjellur DPUMM për zbatueshmërin e këtij dokumenti planor.

### Shqyrtimi i lëndëve në fushën e urbanizmit

Nr.	Llojet e kërkesave	Kërkesa të pranuar në 2023	Kërkesa të bart. nga 2022	Të pezullu.	Miratu.	Refuz.	ceduar	Në procedu.
1.	Kushte ndërtimore	126	4	2	77	43		8
2.	Leje ndërtimi. te gjitha kategoritë	131	8	3	95	33		8
3.	Leje rrënimi	21	-	1	12	6		2
4.	Certifikatë perdorimi	11	3	3	3	3		5
5.	Emërtim rruge, adresa	37					37	-
6.	Informacione urbane	92	1		84	6	1	2
7.	Të tjera	230	14	2	162	24	50	6
	<b>Totali</b>	<b>648</b>	<b>30</b>	<b>11</b>	<b>433</b>	<b>110</b>	<b>88</b>	<b>31</b>

### OBJEKTIVAT VJETORE NË PROCESIN E LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE PA LEJE NDËRTIMI

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi.

Gjatë vitit 2023 në procedure shqyrtimi kanë qenë 139 lëndë për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi. Të bartura nga viti 2022 ishin 108 lëndë, kurse gjatë viti 2023 janë pranuar 31 lëndë. Prej 139 lëndëve tyre janë shqyrtuar 66 lëndë.

Lëndët e pranuar dhe shqyrtuara

Nr.	Lëndë legalizimi	Pranuar në 2023	Bartur nga 2022	Miratuar	Listë të pritjes	Refuz.	Pezull	Procedurë
1.	139	31	108	30	13	21	2	73

### OBJEKTIVAT VJETORE NË FUSHËN E BANIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Në kuadër të objektivave vjetore në fushën e banimit dhe mbrojtjes së mjedisit janë realizuar këto aktivitete:

Në fushën e banimit, **përkatësisht sistemit të adresave** është arritur të përmbillet procesi i regjistrimit të adresave në sistemin ARIS. Ky aktivitet është përkrahur nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e cila përmes USAID-it ka paguar dy punonjëse për 7 muaj.

Është realizuar një takim pune në kuadër të projektit nga CaCH "Youth Environmental Impakt" (YENI) përmes projektit nga OJQ GAC "Youth in Action on Climate Change", me focus - "Përfshirja e të rinjëve në planet lokale të veprimit në mjedis". Pjesëmarrës ishin Eco klubet në kuadër të shkollave të mesme "Adem Gllavica", "Ulpiana" dhe "Shaqir Hoxha".

### AKTIVITETET TJERA NË KUADËR TË KOMISIONEVE DHE GRUPEVE PUNUESE DHE PJESËMARRJA NË TAKIME TË TJERA

Zyrtarët e DPUMM-së kanë marrë pjesë në disa aktivitete të caktuara qoftë sipas detyrës zyrtare apo në bazë të vendimeve të caktuara nga organet kompetente. Në kuadër të aktiviteteve të tjera dhe të kryera gjatë vitit 2023 përfshihen edhe aktivitetet si në vijim:

- Janë përgaditur dhe plotësuar Formularët TM4, TM4 dhe TM5, sipas kërkesës së ASK-së - raportimi për ndërtimet;
- Është plotësuar Pyetësori i kërkuar nga OSBE dhe MMPHI, për "Procesin e Legalizimit" duke theksuar komunitetet joshumicë dhe personat e zhvendosur, si dhe për proceset e planifikimit hapësinor dhe banimit social;
- Janë përfunduar të gjitha aplikacionet e dorëzuara nga palët për aplikim në grante të MBPZHR, për të cilat janë lëshuar Informacione urbane;
- Është plotësuar Raporti për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda evropiane;
- Punonjësit e DPUMM kanë marrë pjesë në punën e Komisioneve të ndryshme, grupeve punuese dhe në takime të tjera.

A	Aktiviteti	Lloji	Lokacioni	Të arriturat
<b>PJESËMARRJA NE KOMISIONE DHE GRUPE PUNUESE</b>				
1.	Aktivitetet e DPUMM në kuadër të Komisioneve, Grupeve Punuese dhe në aktivitetet të tjera.	Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave	Lipjan	Miratuar
2.		Lansimi i platformes "Harta digjitale e Komunës "	Lipjan	Përfunduar
3.		Sistemi i Menaxhimit të shërbimeve të Performancës Komunale 2022	Prishtinë	Finalizuar
4.				
5.		Draft Plani për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera	Lipjan	Proces
6.		Rihartimi i planit të ri të integritetit për komunën	Lipjan	Proces
7.		Ekipi komunal për certifikim në programin BFC- SEE projekt.	Lipjan	Përfunduar
8.		Pjesëmarrje në takim konsultativ - VORAE - çështja e banimit për kategoritë RAE	Lipjan	Proces
		Pjesëmarrje në Komisionin e Ankesave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale	Liojan	Përfunduar
9.		Vlerësimi i punimeve në rrugën "Shqipëria" dhe "Haradin Bajarmi"	Lipjan	Proces i pa pranuar
10.		Plani për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit.	Lipjan	Miratuar me Vendimin e KK
11.		Verifikimi, Arkivimi dhe asgjësimi i lëndëve në arkivin komunal	Lipjan	Finalizuar
12.		Pjesëmarrje në komisione për pranime teknike të projekteve të përfunduara	Lipjan	"
13.		Pjesëmarrje në vlerësimin e ofertave në aktivitetet e prokurimit	Lipjan	"
14.		Takim senzibilizues dhe informues me nxënësit e shkollave fillore me rastin e 22 Majit "Dita ndërkombëtare e tokës"	Lipjan	"
15.		Pjesëmarrje në Komision për shqyrtimin e kërkesave për LMK	Lipjan	Në vazhdimësi
16.		Komisioni për monitorimin e zbatimit të Kontratave / pronës komunale	Lipjan	Në proces
17.		Vlerësimi i tenderit/ ofertat për aktivitetin e prokurimit – hartimi i projekteve - 3 lote	Lipjan	Në proces
18.		Pjesëmarrje në Takimin konsultativ për zgjerimin e terminalit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës	MMPHI	Në proces
19.		Pjesëmarrje në grupin punues për identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e veprimeve ndaj rrezikut në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktivitetëve nga drejtoratet përkatëse të Komunës	Lipjan	Finalizuar
20.		Pjesëmarrje në takimet e Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor	Prishtinë	Në vazhdimësi

## KRYERJA E DETYRAVE, KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

Aktivitetet e caktuara janë realizuar në një masë të konsiderueshme dhe vlerësojmë se janë realizuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Në kryerjen e aktivitetëve të caktuara, DPUMM ka komunikuar me palët sipas interesimit të tyre dhe në raste të caktuara, palët janë ftuar për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme lidhur me kërkesat e parashtruara.

Në faqen zyrtare të internetit janë publikuar format e kërkesave të nevojshme që parashtrohen nga palët dhe informacione të tjera nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit. Po ashtu janë të publikuara edhe aktet përkatëse nënligjore që ndërlidhen me planifikimin urban dhe çështjet e ndërtimeve.

Puna e DPUMM është e hapur dhe aktet e duhura janë publikuar në faqen zyrtare të internetit. DPUMM përmes njësisë përkatëse iu ka përgjigjur të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Po ashtu në kuadër të detyrave të caktuara, DPUMM ka zhvilluar disa aktivitete në bashkëpunim me njësitë tjera organizative të Komunës dhe në formë të hapur për publikun si:

- Bashkëpunimi me Drejtoratet përkatëse dhe subjektet tjera rreth finalizimit të të dhënave për Planin Zhvillimor Komunal.
- Konsultimi publik lidhur me tri fazat e para të Planit Zhvillimor Komunal.
- Konsultimi publik lidhur me Raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për PZHK-në.

DPUMM i ka të publikuara në faqen zyrtare të Komunës të gjitha dokumentet planore, formularët për aplikim për çështje urbane së bashku me udhëzimet përkatëse dhe po ashtu publikon për çdo vit listen e lejeve të lëshuara ndërtimore.

## INDIKATORËT E PERFORMANCËS

Në këtë Shtojcë të Raportit përfshihen të dhënat për aktivitetet e realizuara sipas indikatorëve të performancës të cilat janë nën përgjegjësinë e DPUMM-së. Të dhënat shtesë të raportuara kanë të bëjnë me dy fusha:

1. Planifikimin Hapësinor; dhe
2. Mbrojtjen e Mjedisit

### PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Sipërfaqja e territorit të komunës i mbuluar me plane rregulluese (të hollësishme). Territori i komunës së Lipjanit përfshinë një sipërfaqe prej 338.54 km<sup>2</sup>.

Sipërfaqja e territorit të komunës së Lipjanit në aspektin e planifikimit hapësinor është e mbuluar me Planin Zhvillimor Komunal dhe me Harten Zonale të Komunës (HZK).

HZK është miratuar në qershor të vitit 2021 dhe si rregullim hapësinor përfshinë tërë territorin e komunës, duke përcaktuar zonat e planifikuara sipas destinimit. Në bazë të këtij dokumenti, DPUMM ka bazë ligjore të shqyrtoj kërkesat dhe të lëshoj leje ndërtimi në të gjitha zonat e lejuara për ndërtim sipas HZK, duke përfshirë si zonën urbane ashtu edhe ato rurale.

Deri më tani nuk është nxjerrë ndonjë plan rregullues i hollësishëm pasi që me HZK mbulohet mjaftueshëm rregullimi hapësinor i tërë territorit.

### Kërkesa të shqyrtura për leje të ndërtimit

Në vitin 2023 janë pranuar 131 kërkesa për leje ndërtimi të kategorive të ndryshme dhe 8 të tjera kanë qenë të bartura nga viti paraprak. Prej 131 lëndëve të pranuar janë shqyrtuar 123 lëndë apo 93.89%. Të miratuara dhe janë lëshuar 87 leje ndërtimi. Të kategorisë së I-rë 42 lëndë dhe 45 të kategorisë së II-të.

Nëse i referohemi edhe lëndëve të bartura nga viti 2022 atëherë gjithsejtë në vitin 2023 kemi pasur 139 lëndë për leje ndërtimi. Prej tyre janë shqyrtuar 131 lëndë, ku janë miratuar 95 kërkesa. Prandaj gjatë vitit 2023 janë lëshuar 48 leje ndërtimi për kategorinë e I-rë dhe 47 leje ndërtimi për kategorinë e II-të.

### Ndërtesat e reja të inspektuara

Sipas të dhënave nga Drejtorati i Inspektoratit janë inspektuar gjithsejtë 61 ndërtesa të reja.

### Objektet e reja me leje të ndërtimit

Sipas të dhënave nga Drejtorati i Inspektoratit objekte të reja me leje ndërtimi që kanë filluar të ndërtohen gjatë vitit 2023 janë 61.

### MBROJTJA E MJEDISIT

Realizimi i planit të veprimit lokal në mjedis.

DPUMM gjatë vitit 2022 ka hartuar Planin Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe i njejtë është miratuar dy herë në Kuvendin e Komunës. Të dy herat nuk kemi marrë konfirmimin e ligjshmërisë së Planit nga Ministria përkatëse. DPUMM gjatë vitit 2024 ka planifikuar hartimin e sërishëm të këtij Plani.

Lejet mjedisore komunale të lëshuara

Sipas legjislacionit në fuqi Lejet mjedisore komunale (LMK) lëshohen për një numër të caktuar të objekteve të kategorisë së II-të. Gjatë vitit 2023 janë lëshuar 28 LMK.

# DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

## PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër ka vazhduar me ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare.

### Sektori i Gjeodezisë

Në sektorin e gjeodezisë në vitin 2023 kemi pasur shumë kërkesa nga persona fizik për realizimin e punëve gjeodezike si: regjistrimi ndarjeve, bashkim i parcelave dhe punë tjera ku jemi munduar që me mundësitë të kryekmë kërkesat e tyre, ku janë kryesisht ndarja e parcelave që personat e ndryshëm ti kryejnë trashëgimitë për rregullimin e qështjeve që lidhen me pronën e paluajtshme

### KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuar	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Gjithsej
782	-	782	779	3	-	779

### KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT NUK ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Kopje Plani	2039
2	Konsultime me palë	302
3	Marrje e produkteve	533

### KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. I LËNDËVE	SHËNIM(vërejtje) 647
1	Ndarje të parcelave(regjistrim i ndarjeve)	710	në zyrë
2	Punë për shërbimin pronsor- juridik	27	në terren
3	Rirregullim kufiri	2	në zyrë
4	Ndërrimi kultures së parcelave	6	në zyrë
5	Matje e objekteve	6	në zyrë
8	Bashkim i parcelave	16	në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	12	në terren

### Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur llojet e punë të kryera në vitin 2023

Muaji	Regj.ndar	Marrje e produk.	Historia.i parcelles	Regj. I pjesve te ndertesave	Bashkim i parcelave	Ndrrim i kultures	Matja e ndertesave	Rirreg. kufiri
Janar	61	22	-	-	3	-	-	-
Shkurt	51	41	-	1	2	1	-	-
Mars	62	42	-	1	1	-	1	-
Prill	24	47	-	1	1	-	1	-
Maj	42	41	-	2	2	1	-	-
Qershor	51	50	-	1	1	-	1	1
Korrik	60	55	-	1	-	1	1	1
Gusht	138	78	-	1	1	1	-	-
Shtator	71	35	-	1	-	1	2	-
Tetor	58	38	-	2	2	-	-	-
Nentor	71	41	-	1	3	1	-	-
Dhjetor	48	43	-	-	2	-	-	-

## Sektori Kadastrit

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë vitit 2023 janë të prezentuara në formë tabelare.

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr. i kërkesave të pranuar gjatë këtij viti	Nr. i kërkesave nga viti i kaluar	Të pezulluara	Të miratuara (kryera)	Të refuzuara	Në procedurë
1	Regjistrim prone	2074	-	-	1980	4	90
2	Regjistrim dhe fshirje të Hipotekave	215	-	-	209	2	4
3	Të tjera, Historiat, modifikim i te dhenave, regjistrim i mase se perkohshme	238	-	-	237	2	2
4	Çertifikata të Pronësisë	6072	-	-	6072	-	-
5	Vërtetime për raste sociale	5196	-	-	5196	-	-
6	Njoftim për palen e interesuar lidhur me te dhenat kadastrale	18	18	-	-	-	-
7	Gjithsej:	13813	18	-	13694	8	96

## Raporti i lëndëve të regjistruara sipas gjinisë për vitin 2023

Bashkëshortë	Burra	Gra	Persona Juridik
434	1379	144	117

Gjatë vitit 2023 janë paraqitur numër i madhe i kërkesave për tu shqyrtuar.

Në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, kemi pranuar dhe shqyrtuar këtë numër të lëndëve **17.469**

Sfidues ka qenë edhe këtë vitë numri i vogël i zyrtarëve që kanë ofruar shërbime për qytetar në krahasim me numrin e kërkesave

## Bashkëpunimet

Gjatë periudhës së vitit 2023 kemi pasur bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; me zyrtarët e Agjencionit kadastral kemi mbajtur takime të rregullta për avancimin e punës profesionale në drejtorat.

Gjatë këtij viti kemi mbajtur takime të rregullta edhe me zyrtar të organizatave të ndryshme.

## DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Në bazë të përgjegjësisë dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 01.01.2023 deri 31.12.2023, DI ka kryer aktivitetet të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
195	150	20	20	5

Gjatë kësaj periudhe **Janar – Dhjetor 2023**, Departamenti për Infrastrukturë ka përgaditur dhe proceduar në procedurë të publikimit të gjitha projektet e planifikuara në kuader të Departamentit për Infrastrukturë, si dhe ka përgaditur paramasat dhe paralogaritë për projekte të cilat janë në kuadër të departamenteve tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2023, Drejtoria për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka proceduar me kërkesa në prokurim për projekte tjera me bashkëfinancim siç janë:

Asfaltimi i rrugës transit lagjësja e Konjuhut deri te Rruga regionale Lipjan- Janjevë faza II

Ndërtimi i ujësjellësi në Vrellë të Magures dhe Gypi furnizues Gllavic – Babush

Ndërtimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë faza II

Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Banullë

Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën "Ismajl Luma" Lipjan

Rikostruimi I rruges “Fehmi Agani” Lipjan

Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi I rruges se Lumit në fshatin Gadime e Ulët

Prrockat (Lumejt) në Lipjan

Ndërtimi I qerndes në Rufc të Ri Faza II

Nga grandit i performances për vitin 2023: **1,843,786.22 Euro.**

**Statistikat e projekteve :**

	<b>Emri I Projektit</b>	<b>Asfaltim m'</b>	<b>Trotuar m'</b>	<b>Ndriqim m'</b>	<b>Shenjezi m'</b>	<b>Kanalizim</b>	<b>Shtegu i bicikletave</b>
1	Asfaltimi i rrugës tranzit –lagjeja e Akllapit	1575	1575	1575	1575	1575	1575
2	Rikonstruimi i rrugëve ne Ribar te Madh ( rr.Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi, ) Riasfaltim	1605	1305		1605		
3	Shtigjet e ecjes ne Sllovi	3268		3268	3268		3268
4	Shtigjet e ecjes ne Gadime faza e dyte	2497		2497	2497		2497
5	Hapja dhe ndërtimi i rrugëve te reja brenda ne Qytetin e Lipjanit (Rruga Arfim Zhithia, Rr.Bashkim Krasniqi-te rr.Haradin Bajrami- rr.Haxhi Kleqka)	1200	2400	2400	2400	1500	1200
6	Asfaltimi i rrugicave ne Krojmir, Shale, Resinoc, Qylage, Magure,Vershevc, Baice,Kraishtë Faza III	4735.51					
7	Ndërtimi I rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushe, Gumnaselle, Llugaxhi dhe Babush	11600	500				
8	Asfaltimi i rrugës rreth lumit në Gadime	960					
9	Asfaltimi I rruges se Shkupit dhe rruges se Lumit ne Gadime	350					
10	Asfaltimi i rrugës Kraishte- Bujan	1300			1300		
11	Ndërtimi I trotuarit ne rrugen Gadime - Llugaxhi		1600				
12	Asfaltimi I rrugicave ne Sllovi	4600					
13	Rregullimi I infrastruktures ne Janjeve	800 m' Kubza				400	
14	Aneke te rrjetit te Kanalizimit ne Lipjan, Akllap, Krojmir, Rubovc, Sllovi, Gracke,Mirene, Babush faza III					2000	
15	Rehabilitimi I infrastruktures ne zonen e qendres Kulturore Historike ne fshatin Janjeve					2000	
16	Rrjeti I Kanalizimit ne Akllap					1300	
17	Ndërtimi I trotuarit në Krojmir		1093				
<b>Gjithsej</b>		<b>33690.51</b>	<b>8473</b>	<b>9740</b>	<b>12645</b>	<b>8775</b>	<b>8540</b>

<b>Projektet tjera:</b>		
Zbatimi i masave efijente ne objektin qendra ne Lipjan (fasadimi i objektit te ish barnatorja e shtetit)		Perfunduar
Ndërtimi i nënkalimit dhe vazhdimi i ndërtimit te sheshit		Vazhdon

<b>Nr.</b>	<b>Lumenjët</b>	<b>m'</b>
1	Ndërtimi i shtratit te lumit ne Gadime	<b>400 m'</b>
2	Ndërtimi i shtratit te lumit ne Smallushe	<b>644 m'</b>
3	Ndërtimi i shtratit te lumit ne Gllgovc	<b>545 m'</b>
4	Ndërtimi i shtratit të lumit në Gadime dhe asfaltimi i rrugës rreth lumit	<b>700 m'</b>
5	Ndërtimi I prockave te shtrereve te lumenjeve ne qytetin e Lipjanit	<b>475 m'</b>
<b>Gjithësej :</b>		<b>2764 m'</b>

<b>Shendetesi</b>		
1	Renovimi i QMF-së në Gadime dhe Babushë	E perfunduar
2	Renovimi i QMF-se ne Babushe	E perfunduar
3	Renovimi i QMF-së në Janjevë	E perfunduar

<b>Ndërtimi i palestrave sportive dhe sallave te sportit</b>		
1	Ndërtimi i Palestres së re sportive në Lipjan	E perfunduar
2	Ndërtimi i salles sportive ne Gllgovc	E perfunduar

3	Ndërtimi i salles sportive në Banullë	E perfunduar
4	Ndërtimi i salles sportive në shkollën "ismail Luma" në Lipjan	Vazhdon
5	Ndërtimi i fushës së hapur sportive në Rubovc	E perfunduar
6	Vendosja e barit sintetik dhe uleset në fushat e hapura sportive në Ribar të Madh, Slllovi, Kraishtë etj	Vazhdon

Arsimi		
1	Ndërtimi i shkolles në Ribar të Madh	E perfunduar
2	Ndërtimi i Qerdhes në Shale	E perfunduar
3	Ndërtimi i Qerdhes në Rufc të Ri	E perfunduar
4	Renovimet e shkollave paralele të ndara në (Jeta e re, Konjuh, Vershevc, Resinovc, Lluga, Gadime e Ulet, Vrelle e Goleshit, Krojmir, Mirene, Zllakuqan.Faza II	E perfunduar
5	Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkollën fillore në fshatrat: Dobraje e Madhe, Kraishte, Rubovc, Banulle, Babush i Muhaxhereve, Llugaxhi, Smallushe, Shale, Krojmir, Topliqan, Baice, Poturovc, Medvec, Magure, Bujan, Glllogovc, Lipjan Faza II 52166	E perfunduar
6	Ndërtimi i Kendeve e lojrave për fëmijë në Lipjan, Slllovi, Gadime.	E perfunduar

## Memorandumet

Janë nënshkruar Memorandume bashkëfinancimi në vlerë: **782,691.00 Euro**.

Disa nga këto projekte janë ekzekutuar gjatë vitit 2023 ndërsa disa të tjera janë në proces të realizimit.

**Gjatë kësaj periudhe Drejtorati për Infrastrukturë i është drejtuar MMPHI edhe për projektet si:**

Asfaltimi i rruges Topliqan-Kojskë

Asfaltimi i rruges Llugaxhi-Babush i Muhaxhereve

Asfaltimi i rruges Gadime e Ulet ( Lagjja e Ejupve) -Gadime e Eperme

Asfaltimi i rruges Afrim Zhitia në qytetin e Lipjanit

Asfaltimi i rrugës në fshatin Plitkoviq

Ndërtimi i kolekorit të kanalizimit fekal Bregu i zi, Bujan, Grackë e Vogel Topliqan Asfaltimi i rruges Teqe – Shashkovc – Bukovic

Rregullimi i shtratit të Lumit në fshatin Qallapek

Rregullimi i shtratit të Lumit në fshatin Slllovi

Rregullimi i shtratit të Lumit në fshatin Janjevë

Rregullimi i shtratit të Lumit në fshatin Blinajë

Ndërtimi i rreth-rrotullimit në udhëkryqin Llugaxhi – Gadime

Ndërtimi i rreth-rrotullimit në udhëkryqin Suhadoll – Lipjan (Te zjarrfiksit)

Rikonstruimi i rrugës Poturovc – Ribar i madhë

Rikonstruimi i rrugës Rufc i ri – Ribar i vogël

Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të Lumit Gadime e Ulët

**Por ende nuk ka marr asnjë përgjigje nga Ministria në fjalë.**

## Dinamika e ekzekutimit të projekteve

Gjatë vitit 2023 janë menaxhuar 52 projekte në fusha të ndryshme. Kanë përfunduar gjithsej 34 projekte, ndërsa në proces janë 13 projekte të cilat do të vazhdojnë gjatë vitit 2024.

Vlen të veçojmë se gjatë vitit 2023 janë shkëputur 4 kontrata për arsye të mos përmbajtjes së dinamikës së punimeve dhe për arsye të cilësisë së punimeve dhe 1 ka dështuar në procedurë të tenderimit.

Nr	Projektet nga Drejtoria për infrastrukturë dhe Donatorët	
1.	Ndërtimi i nenkalimit dhe vazhdimi i ndërtimit të sheshit, Ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe Parkingut nëntokësor në Lipjan,	Vazhdon
2.	Ndërtimi i rruges Hallaq i Madhe-Rufc i Ri 43089	I përfunduar
3.	Ndërtimi i rruges Ribar i Madh - Ribar i Vogel (49154)	I përfunduar



4.	Ndertimi i trotuarit me ndriqim publik ne Akllap 49150	I përfunduar
5.	Ndertimi i trotuarit me ndriqim publik ne Gllavic-Marevc 47955	I përfunduar
6.	Ndertimi i rrugeve ne lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime,Smallush ,Gomaselle,Llugaxhi,Babushe.51429	Vazhdon
7.	Ndertimi i shtratit te lumit ne Smallushe 49139	I përfunduar
8.	Vazhdimi i ndertimit te shtratit te lumit ne Gadime 51410	Është shkëputur kontrata
9.	Ndertimi i shtratit te lumit ne Glllogovc 45389	I përfunduar
10.	Ndertimi i shtratit te lumit ne Ribar te Madh 45396	I përfunduar
11.	Rikonstruimi i rrugeve ne Ribar te Madh ( rr.Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi, ) (51411)	I përfunduar
12.	Rikonstruimi i rruges Poturovc- Dobraje te Madhe 51413	I përfunduar
13.	Shtigjet e ecjes ne Sllovi 51414	I përfunduar
14.	Shtigjet e ecjes ne Gadime faza e dyte 51415	I përfunduar
15.	Ndriqimi publik ne Miren 50871	I përfunduar
16.	Rikonstruimi i rruges Zylfie Gashi ne Lipjan 51428	I përfunduar
17.	Ndertimi i Rruges Bujan- me rrugen per Kraishte 50874	I përfunduar
18.	Rregullimi i shtratit te Lumit Janjevka ne lagjen e Konjuhut ne Lipjan 51420	I përfunduar
19.	Hapja dhe ndertimi i rrugeve te reja brenda ne Qytetin e Lipjanit (Rruga Arfim Zhitia, Rr.Bashkim Krasniqi-te rr.Haradin Bajrami- rr.Haxhi Kleqka,	Vazhdon
20.	Ndertimi i trotuarit ne rrugen Gadime-Llugaxhi	Vazhdon
21.	Ndertimi i trotuarit ne Krojmir	Vazhdon
22.	Rikonstruimi i rruges se shkolles ne Dobraj te Madhe dhe rrugicat tjera	Është shkëputur kontrata
23.	Aneke te rrjetit te Kanalizimit ne Lipjan, Akllap, Krojmir, Rubovc, Sllovi, Gracke,Mirene, Babush Faza III	Vazhdon
24.	Asfaltimi i rrugicave ne Krojmir, Shale, Resinoc, Qylage, Magure,Vershevc, Baice,Kraishtë Faza III	Vazhdon
25.	Asfaltimi i rrugës transit lagjësja e Konjuhut deri te Rruga regjionale Lipjan- Janjevë faza II	I përfunduar
26.	Ndërtimi i ujësjellësi në Vrellë të Magures dhe Gypi furnizues Gllavic – Babush	Projekti ka dështuar në procedur të tenderimit
27.	Ndertimi i shtratit të lumit në fshatin Smallushë faza II	Është shkëputur kontrata
28.	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Banullë	I përfunduar
29.	Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën “Ismajl Luma”Lipjan	Vazhdon
30.	Ndertimi i qerdhes ne rufc te ri Faza II	I përfunduar
31.	Rikostruimi i rruges “Fehmi Agani” Lipjan	Vazhdon
32.	Ndërtimi i shtratit të lumit dhe asfaltimi i rruges se Lumit në fshatin Gadime e Ulët	I përfunduar
33.	Prrockat (Lumejt) në Lipjan	I përfunduar
34.	Zbatimi i masave efikente ne objelitin Qendra ne Lipjan	I përfunduar
35.	Ndertimi i rrugicave ne lagjet e fshatit Krojmir, Kraisht dhe Zllakuqan faza e II	Është shkëputur Kontrata
36.	Rregullimi i hapsirave publike ne Lipjan (Shtigjet e ecjes)	I përfunduar
37.	Rregullimi i infrastruktures ne Janjeve	I përfunduar
38.	Rehabilitimi i infrastruktures ne zonen e qendres Kulturore Historike ne fshatin Janjeve	Vazhdon
39.	Asfaltimi i rrugicave ne lagjet e fshatit Sllovi – Faza e III-te (Projekt I ri)	Vazhdon
40.	Asfaltimi i rrugicave ne lagjet e fshatrave Shale, Resinoc, Qylage, Magure,Vershevc, Baice, Ribari Madh, Bujari faza e IV-te (72project I ri)	Vazhdon
41.	Rikostruimi i rrjetit te kanalizimit ne Akllap (Projekt I ri)	I përfunduar
42.	Renovimi i AMF Babush	I përfunduar
43.	Ndertimi i rruges Gryka e shpetimit Krojmir	I përfunduar
44.	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Medvec	I përfunduar
45.	Rregullimi i infrastruktures rrethe qeshmes ne Medvec	I përfunduar
46.	Ndertimi i shkolles ne Ribar te Madh	I përfunduar
47.	Ndertimi i Qerdhes ne Shale	I përfunduar
48.	Ndertimi i Qerdhes ne Rufc te Ri	I përfunduar
49.	Renovimet e shkollave paralele te ndara ne (Jeta e re, Konjuh, Vershevc, Resinoc, Lluga, Gadime e Ulet, Vrelle e Goleshit, Krojmir, Mirene, Zllakuqan.Faza II	I përfunduar
50.	Ndertimi i parqeve dhe lojrave per femije ne shkolla fillore ne fshatrat: Dobraje e Madhe, Kraishte, Rubovc, Banulle, Babush i Muhaxhereve, Llugaxhi, Smallushe, Shale, Krojmir, Topliqan, Baice, Poturovc, Medvec, Magure, Bujan, Glllogovc, Lipjan Faza II 52166	I përfunduar
51.	Ndertimi i Kendeve e lojrave per femije ne Lipjan, Sllovi, Gadime.	I përfunduar
52.	Asfaltimi i rrugës së Shkupit dhe rrugës së Lumit në Gadime të Ulët faza II	Vazhdon

Sektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit përfundimtar të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojm angazhimin në kuadër të grupit të performancës, pastaj në grupin e punës për ekselencë, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj.

Departamenti infrastrukturës ka ndërtuar sistemin elektronik të të dhënave të infrastrukturës në territorin e komunës tonë të cilat të dhëna përditësohen, varsishte nga zhvillimi i ndërtimit të Infrastrukturës në teren.

## DREJTORATI PËR INSPEKSION

### PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë vitit 2023 është realizuar agjenda e planifikuar e punës. Pjesë e planit të punës në inspektorat përveç agjendës ishin edhe ankesat – kërkesat e shumta të qytetarëve, të cilat janë shqyrtuar me prioritet.

Janë realizuar inspektime të vazhdueshme në tërë territorin e komunës. Për realizimin e punëve në drejtori janë organizuar edhe kujdestari të shumta, për të ju përgjigjur ankesave dhe parregullsive të paraqitura. Gjithashtu janë realizuar inspektime të ndryshme në bashkëpunimin me Policin e Kosovës – Stacioni Policor në Lipjan.

**Inspektoret e tregut**, gjatë vitit 2023 kanë zhvilluar inspektime të bazuara në planin e punës për vitin 2023. Qëllim kryesor i inspektorëve të tregut është që të punojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret komunale, për parandalimin e ekonomisë joformale, sigurinë e përgjithshme të produkteve të plasuara në treg, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Objektivë inspektimi për inspektorët e tregut në vazhdimësi gjatë tërë vitit që lamë pas kanë qenë inspektimet e subjekteve të ndryshe biznesore si: inspektim i marketeve ushqimore (krahasimi i çmimit raft-arkë), vendosja e flamujve të origjinës në rafte, kushtet e ruajtjes së produkteve, barnatoret humane, mishtoret, sallonet e ondulimit, lokalet për shitjen dhe servisim të telefonav mobil, industri të drurit, furrat e bukës, mullinjët e grurit, auto-sallonet e veturave, barnatoret bujqësor, dyqanet të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve dhe biznese të tjera. Qëllimi i inspektimit ka qenë rreth regjistrimit të biznesit, pranimeve teknik, çmimeve të deklaruara, gramazha, përputhshmëria e çmimeve raft-arkë, vendosja e flamujve-tregues të origjinës së produkteve, çertifikimi i kalibrimit të peshoreve.

Në bizneset të cilat kemi hasur parregullsi është iniciuar procedurë kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prishtinë-dega Lipjan.

Për inspektorët e tregut prioritet mbetet pranimi teknik i lokaleve në të cilat realizohet biznes. Janë realizuar urdhëresa për regjistrim të lokaleve dhe urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste.

Nga inspektorët e tregut gjatë vitit janë mbyllur katër lokale afariste të cilat nuk i kanë plotësuar kushtet për të ushtruar aktivitetin biznesor.

Nga sheshi "Adem Jashari" dhe nga rrugët kryesore të qytetit janë larguar shitës ambulant, të cilët realizonin aktivitetin e tyre pa pasur pëlqim nga organet kompetente komunale.

Objektivë tjetër e inspektoreve të tregut gjatë këtij viti ka qenë edhe inspektimi i bizneseve në lidhje me zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QKR) NR07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit (posaçërisht përmbajtja e specifikacioneve të cilat kërkohen me udhëzimin administrativ).

Në vazhdimësi është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve, nuk është lejuar asnjë lloj shitje jashtë tregut. Prioritare ka qenë edhe ndalimi i shitjes jashtë tregut.

**Inspektori i mjedisit-ambientit**- Nga sektori i mjedisit-ambientit gjatë vitit 2023 në ruajtjen e ambientit është punuar sipas planeve për inspektime – kontrollera nga Drejtoria e Inspektoratit. Në planin dinamik është paraparë kontrollera të shpeshta në deponit ilegale të mbeturinave që ekzistojnë në komunën tonë. Janë realizuar gjopa për të gjithë ata të cilët janë takuar duke hedhë mbeturina apo ndaj të cilëve janë gjetur dëshmi për ndotje të hapësirës publike, natyrës dhe ndotjen e ajrit si pasojë e ndezjes së mbeturinave. Inspektori i ambientit është angazhuar vazhdimisht për mbrojtjen e ujërave të lumenjve, mbikëqyrjen e lejeve mjedisore komunale, mbrojtjen nga zhurmat eventuale, mbikëqyrjen e menaxhimit të mbeturinave komunale dhe bartjes së tyre nga kompania e licencuar, pranimi ankesave të qytetarëve dhe shqyrtimi i tyre në teren, si dhe kontrollera tjera që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjedisit-ambientit sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

Sipas rregulloreve komunale janë detyruar të gjitha bizneset për t'u pajisur me pëlqim nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për shfrytëzim të hapësirës publike.

Është bërë kontroll në objektet me shumë njësi banimi, si dhe objekte tjera afariste të cilat janë në ndërtim apo bizneset që zhvillojnë aktiviteti në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Janë dhënë urdhëresa për grumbullim e mbeturinave në vend punishte, vendosja e tyre në kontejner, dorëzimi i tyre Kompanisë Pastrimi, gjithashtu janë dhënë urdhëresa për rregullimin e hapësirave gjelbëruese, rregullimin e vendit për kontejner pas përfundimit të ndërtimit, si dhe zbatimin e kushteve të LMK-së.

**Inspektorët e trafikut-** përgjatë vitit inspektorët e trafikut kanë ndjekur agjendën vjetore për punët brenda kompetencës së tyre. Objektivi e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, i auto – taksive, radio – taksiv si dhe kombi – taksi ilegal.

Kanë realizuar inspektime, pika kontrolli për të përcjell rendet e udhëtimit nga kompanitë e ndryshme të autobusëve. Gjatë vitit janë ballafaquar me problemin e taksistëve – fizik pa licencë dhe taksistëve – juridik pa licencë. Ndaj të gjitha rasteve të ndaluara e të identifikuar si të pa rregullta, janë marr të gjitha masat ligjore si: vërejtje, përjashtim nga komunikacioni – marrje e tabelave dhe janë shqiptuar gjoba. Janë realizuar kujdestari. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës janë realizu pika kontrolli për të përcjell rendet e udhëtimit nga kompanitë e ndryshme të autobusëve.

Është organizuar aksion në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësia në Lipjan në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” ku është bërë inspektim i auto – taksiv “Ulpiana”.

Pjesë e inspektimeve kanë qenë rrugët në qytet dhe në fshatra, për secilën prerje, dëmtim dhe baltosje të rrugëve nga kompanitë e ndërtimeve janë marr të gjithë hapat procedural ligjor.

Inspektorët e trafikut kanë inspektuar trotuaret në qytet ku për disa biznese kanë dhënë vërejtje që reklamat mos ti vendosin në trotuar sepse pengojnë lëvizjen e këmbësorëve.

**Inspektorët e ndërtimit** - gjatë vitit që lamë pas në vazhdimësi janë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në të gjitha zonat e ndërtimit, duke përfshi edhe periferinë e qytetit. Gjendja e ndërtimit për gjatë gjithë vitit ka qenë nën kontrollin e vazhdueshëm inspektues. Janë identifikuar një numër i vogël i objekteve pa Leje ndërtimi në zonat e ndërtimit, ndaj të cilave janë ndërmarrë masa ligjore konform Ligjit të Ndërtimit e dispozitave ligjore në fuqi. Inspektimet tjera rezultojnë të pajisura me leje ndërtimi nga organi kompetent.

Inspeksioni ka pasur bashkëpunimi të kordinuar me Policinë duke njoftua për secilin ndërtim të filluar pa Leje. Inspektorët e ndërtimit janë përgjigjur në kërkesave për inspektim të fazave nga Investitorët, kërkesave për Raporte Finale për tu pajisur me Çertifikatë Përdorimi për objektet e përfunduara-finalizuara nga Investitorët.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2023 :

Janë inspektuar lokalet afariste, si: marketet, barnatoret humane, mishtoret, furrat e bukës, mullinjët e grurit, auto-sallonet e veturave dhe veprimtari të tjera ekonomike ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Inspektim i marketeve lidhur me zbatimin e Ligjit 06/L034 për mbrojtje të konsumatorit.

Inspektimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve.

Inspektimi i bizneseve dhe marketeve të cilat mirren me shitjen e duhanit dhe alkoolit në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.06/L034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Inspektimi i bizneseve lidhje me zbatimin e Udhëzimit Administrativ (QKR) NR07/2023 për Ambalazhin dhe Mbeturinat e Ambalazhit.

Urdhëresa me procesverbal për deklarimin e çmimit të produkteve në raft dhe vendosjen e flamujve-tregues të origjinës.

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste., si dhe janë bërë 100 pranime teknike të lokaleve afariste.

Janë mbyllur katër subjekte ekonomike (të pa regjistruara dhe pa pranime teknike).

Largimi i shitësve ambulant pa pëlqim nga Sheshi “Adem Jashari” dhe rrugët e qytetit.

Ndalimi i tregtimit në rrugët e qytetit (ndalim i shitjes jashtë tregut).

Zbatimi i urdhëresës që ndalon lëvizjen me trotinet elektrik, biçikleta në sheshin “Adem Jashari”.

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për lejet për rrënim.

Inspektimi i auto-taksive lokale, si dhe auto-taksitë që operojnë në ANP-Adem Jashari.

Ndalesa të vazhdueshme dhe ndëshkim për taksistët ilegal.

Inspektimi i radio- auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi-kontrollimi i operatorëve-autobusëve në qytet dhe fshatrat për rendet e udhëtimit.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektim i firmave ndërtimore të cilat e dëmtojnë pjesën e trotuarit gjatë hyrje-daljes nga punishtja me kamion.

Urdhëresa për kryerje të obligimit të pagesës për bizneset ndaj Komunës për shfrytëzimin e hapësirave publike (terasave) sipas rregullores komunale.

Identifikimi i ndotësve përmes dëshmimeve të gjetura në teren, informatave të pranuar nga qytetarë dhe shqiptimi i gjobave.

Kontroll investitorëve të objekteve ndërtimore me shumë njësi banimi dhe subjektet tjera në zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale.

Pëlqimet për hapësirat publike, nga bizneset në qytet.

Shqiptimi i gjobave ndaj ndotësve të mjedisit.

Fletëparaqitje për Kundërvajtje

Shqiptimi i gjobave mandatore.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

## STATISTIKAT

